

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6038
E martë, 16 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Ulqini është bërë gati
për t'i pritur qytetarët
e Kosovës | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 [facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



Më 27 qershor, Kosova dhe Serbia takohen në Shtëpinë e Bardhë

| FAQE 2



I emëruari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka bërë me dije të hënën se qeveritë e këtyre dy vendeve janë pajtuar

që të takohen më 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë, pasi palët janë pajtuar që t'i heqin pengesat për dialog. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka mirëpritur

iniciativën e ShBA-së për rikthimin e dialogut. Thaçi është takuar edhe me kryeministrin Avdullah Hoti për t'u koordinuar në këtë proces

KOSOVA MUND TË PËRFSHIHET
NGA VALA E DYTË E
INFECTIMEVE ME COVID-19 | FAQE 7



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

MË 22 QERSHOR HAPEN
TË GJITHA PIKAT
KUFITARE TOKËSORE | FAQE 3


044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk


PRINCESHA GROUP SH.P.K.

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

ZGJEDHJET NË MAQEDONI NË
E VERIUT DO TË MBAHEN
MË 15 KORRIK | F. 2

REKTORIT BAJRAM KOSUMI I
JEPET ÇMIMI 'IDRIZ SEFERI' | F. 6

TRUSTI: NUK KA ENDE ASNJË
VENDIM PËRFUNDIMTAR PËR
TËRHEOJEN E 10 PËRQINDËSHIT | F. 6

EKONOMI
QEVERIA MIRATON PLANIN
E PUNËS | F. 9

MINISTRI REÇICA PREMTON
RRITJE TË PENSIONEVE BAZË
PËR TË MOSHUARTIT | F. 9



KULTURË
MBYLLET PËR VIZITORË
GALERIA E ARTEVE E KOSOVËS
PËR SHKAK TË COVID-19 | F. 3

SPORT
BOJKU: TA VAZHDOJMË
KËTË SERI TË SUKSESSHME | F. 18


Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Më 27 qershori, Kosova dhe Serbia takohen në Shtëpinë e Bardhë

I emëruari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka bërë me dije të hënën se qeveritë e këtyre dy vendeve janë pajtuar që të takohen më 27 qershori në Shtëpinë e Bardhë, pasi palët janë pajtuar që t'i heqin pengesat për dialog. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka mirëpritur iniciativën e SHBA-së për rikthimin e dialogut. Thaçi është takuar edhe me kryeministrin Avdullah Hoti për t'u koordinuar në këtë proces.

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER)- I emëruari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, njoftoi se qeveritë e këtyre dy vendeve janë pajtuar që të takohen më 27 qershori në Shtëpinë e Bardhë, pasi palët janë pajtuar që t'i heqin pengesat për dialog.

Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", Grenell ka thënë se Serbia u pajtua që të pezullojë përkohësish fushatën e çnjohjeve të pavarësisë së Kosovës.

"Lajm i mirë. Sapo pranova angazhimin e qeverive të

Kosovës dhe Serbisë për të pezulluar përkohësish fushatën e çnjohjeve dhe për të kërkuar anëtarësimë ndërkombëtare, me qëllim që të takohemi në Uashington DC, në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershori, për të biseduar për dialogun. Nëse njëra palë nuk është e kënaqur me bisedimet e 27 qershosit, ato mund të kthehen sërisht në status quo, pasi të largohen nga Uashingtoni. Siç kemi thënë vazdimisht, ne së pari duhet të bëjnë përparim në rrjeten e ekonomive. Ky është fokus. Mirëpres këto diskutime", ka shkruar Thaçi në një postim në "Twitter".



Presidenti Hashim Thaçi ka mirëpritur iniciativën e SHBA-së për rikthimin e dialogut. "Udhëheqësia dhe mbështetja e SHBA-së ka qenë gjithmonë vendimtare për të ardhmen prosperuese të Kosovës. Prandaj, mirëpres iniciativën për rikthimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, nën udhëheqësin Richard Grenell, të dërguarit të presidentit, Donald Trump", ka shkruar Thaçi në një postim në "Twitter".

Në fillim të muajit qershori, Qeveria e re e Kosovës shfuzqizo masat e reciprocitetit ndaj Serbisë dhe tha se pret që Serbia të ndalë fushatën e çnjohjeve, me qëllim që t'i jetet mundësi dialogut. Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian ka nisur më 2011. SHBA-ja emëroi Grenellin si të dërguarin e saj për këtë dialog, tertonin e vittit të kaluar, me qëllim që të ndihmojë palët të arrijnë një marrëveshje paqje.

Ndërkaq, afro tre muaj më herët, BE-ja ka emëruar Miroslav Lajçakun në postin e të dërguarit të posaçëm për dialogun Kosovë-Serbi.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u ndërpren në fund të vitit 2018, pasi Qeveria e Kosovës vendosi një taksë prej 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Më pas kjo taksë u hoq dhe u vendos masa e reciprocitetit, por Serbia tha se nuk do të kthehet në tavolinën e bisedimeve pa heqjen e të gjitha pengesave.

Rrëzohet një avion i Forcave Ajrore amerikane në Detin e Veriut



NJU JORK, 15 QERSHOR - Një pilot i Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara është zhdukur, pasi avioni i tij, i tipit F-15C, u rrëzua në Detin e Veriut më 15 qershori. Avioni i rrëzuar kishte në bord vetëm pilotin i cili po kryente një mision trajnues nga baza ajrore e forcave britanike në lindje të Anglisë. "Shkaku i rrëzimit, por edhe statusi i pilotit janë të panjohura momentalisht. Ekipet e kërkimshpëtimit të Mbretërisë së Bashkuar janë thirrur për të na mbështetur në këtë operacion", tha kapitenja e Forcave Ajrore, Miranda T. Simmons.

Avioni amerikan ishte nisur nga baza RAF Lakenheath në Suffolk, ku janë të vendosur avionët e Forcave Ajrore amerikane.

BBC ka raportuar se besot që avioni të jetë rrëzuar 137 kilometra larg nga brigjet e East Yorkshire. Duke cituar të dhënat e një ueb-faqeje që gjurmuan fluturimet, televizioni Sky News raportoi se avioni amerikan kishte qarkulluar sipër asaj zone para se të zhdukej. RAF Lakenheath është baza më e madhe e Forcave Ajrore amerikane në Britani. Mbi 4 000 pjesëtarë të personelit amerikanë janë të vendosur në këtë bazë.

Rritet sërisht numri i të prekurve me Covid-19 në Kinë

PEKIN, 15 QERSHOR - Pekini ka regjistruar 36 raste të reja lokale me Covid-19 tekxa janë ngjallur shqetësimet për valë të dytë të këtij virusi në kryeqytetin kinez. Vetëm të shtunën janë regjistruar 36 raste të reja.

Ky qytet nuk kishte raportuar për raste të reja në më shumë se 50 ditë.

Nënpresidenti kinez Sun Chunlan u ka bërë thirrje zyrtarëve të marrin "veprime vendimtare", duke paralajmëruar se rreziku i përhapjes është shumë i madh.

Ky shpërthim është lidhur me tregun më të madh të qytetit. Global Times ka raportuar se 79 raste janë të lidhura me tregun Xinfadi.

Tri provinca të tjera, po ashtu, kanë raportuar raste të konfirmuara, që dyshohet se janë të lidhura me Pekinin.



Mediat lokale kanë raportuar se virusi është identifikuar në dërasat për prerje të salmonit të importuar, çka ka shtyrë dyqanet e mëdha në Pekin që ta heqin këtë lloj peshku nga raftet e tyre.

Shkollat dhe kopshtet e fëmijëve janë mbyllur derisa hapja e shkollave për klasat e para, që ishte besuar se mund të ndodhte të hënën, është shtyrë përafat të pacaktuar, ka raportuar "Global Times".

Franca lehtëson masat e izolimit

PARIS, 15 QERSHOR - Presidenti francez Emmanuel Macron ka njoftuar për lehtësim të një morie masash, të zbatuara me qëllim të luftimit të koronavirusit.

Nga dita e hënë kafenetë dhe restorantet mund të hapen në Francë si dhe do të lejohet udhëtimi në shtetet e tjera të Bashkimit Evropian. Banorët e këtij shteti do të mund të vizitojnë anëtarët e

familjes, që jetojnë në shtëpi kujdesi, të cilat janë goditur rëndë nga pandemia me koronavirus. Ky vendim ka ardhur tekxa një numër shtetesh në Evropë kanë rihapur kufijtë e tyre në mes

të bllokut evropian nga dita e hënë. Përmes një adresimi televiziv, Macron ka thënë se Franca ka arritur "fitoren e parë", mirëpo ka paralajmëruar për kthim të mundshëm të virusit.



Ministria e Arsimit: Do të mbahet testi i arritshmërisë për klasat e nënta

EPOKA
ERE

Q. RAMA

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASh), Ramë Likaj, ka mbajtur të hënën një takim me drejtoret e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe drejtoret e departamenteve të MASh-it.

Ministri Likaj i ka njoftuar të pranishmit me dy vendimet që janë marrë për pezullimin e mësimit përgatitor për test të arritshmërisë në shkolla dhe organizimin e mësimit online (mësim në distancë) përmaturantët si përgatitje për testin e maturës. Likaj ka theksuar se këto vendime janë marrë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin Kombëtar të Shëndetësisë

Publike (IKShPK) dhe me Kolegjumin e Drejtoreve Komunalë të Arsimit, duke theksuar se takimi i sotëm është ftuar me qëllim që të propozohen zgjidhje rrith mbajtjes së këtyre dy testeve për shkak të rrezikshmërisë së përhapjes së infekzionit.

Më tutje, Likaj ka përmendur faktin se MSh-ja ka bërë publik "Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19", duke shtuar se të gjitha vendimet që mund të merren duhet t'u përshtaten kërkesave të reja që dalin nga ky manual dhe koha deri data e mbajtjes së testit të arritshmërisë është shumë e shkurtër.

Megjithatë, drejtoret e DKA-ve kanë kërkuar që të mbahet testi i arritshmërisë dhe me kërkesë të tyre u vendos që ky test të



mbahet, pasi drejtoret janë deklaruar se komunat i kanë mundësitet që t'i zbatojnë masat mbrojtëse të këruara nga

institucionet kompetente. Gjatë takimit është diskutuar edhe përgatitjet që janë bërë për testin e maturës dhe

përgatitjet përfillimin e viti të ri shkollor, megjithatë u konstatua se vendimet do të merren konform rrethanave pandemike.

Më 22 qershor hapen të gjitha pikat kufitare tokësore

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Në mbledhjen e mbajtur të hënën, Qeveria e Kosovës ka plotësuar vendimin e qeverisë së kaluar, të datës 31 maj 2020, që ka të bëjë me hapjen e kufijve tokësore. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se me këtë ndryshim do të hapen edhe pikat e tjera kufitare tokësore. "Ky vendim hyn në fuqi më 22 të këtij muaji, duke pasur parasysh se përgatitjet janë më intensive.



Ajtori i kufijve tokësore, që do të hapen prej 22 qershorit janë pikat kufitare Qafë-Morinë, Muçibabë dhe Mutivodë. Ndërkëq Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" ka njoftuar se të gjitha fluturimet e parapara më 15 qershor janë anuluar.

Ambasada e Kosovës në Turqi ka njoftuar se ky shtet ka hapur kufijtë ajrorë e tokësore, por me kufizime. Sipas njoftimit të kësaj ambasade, qytetarët në hyrje do t'u nënshtronen kontrolleve shëndetësore, e në rast se ndonjëri ka simptoma të koronavirusit, atëherë kryhet edhe testimi pa pagesë. Sipas njoftimit të Ambasadës së Kosovës në Turqi, pritet që nga 1 korrik 2020 linjat ajrore në mes të Kosovës dhe Turqisë të fillojnë të qarkullojnë me orar të rregullt.

Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 15 korrik

SHKUP, 15 QERSHOR - Zgjedhjet do të mbahen më 15 korrik. Këtë e ka konfirmuar të hënën lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, i cili ka theksuar se kjo datë është e pranueshme edhe për OBRM-PDUKM-në, të cilën ai tashmë e ka diskutuar edhe me kryetarin e kësaj partie, Hristian Mickoski. "Ne jemi të vetëdijshëm që jemi në një moment të ndërlidhur. Duhet të ndërmarrim hapa të rendësishëm.

LSDM-ja është mbajtësi i pushtetit përgjegjës. Ne duhet bëjmë gjithçka për t'u siguruar institucioneve kapacitet të plotë. Ne kemi nevojë për Kuvend aktiv dhe për një qeveri politike funksionale. Kjo lojë nervash në të cilën vuajnë qytetarët duhet të përfundojë", ka thënë Zaevi në një konferencë përmie.

Më tutje, Zaevi ka treguar se si do të votojnë qytetarët maqe-

dona, duke përfshirë edhe ata me Covid-19. "LSDM-ja po tregon edhe një herë madhështinë e saj, në mënyrë që njerëzit të mos vuajnë, e caktion 15 korrikun si datën përfundimtare dhe të vetme përgjedhjet. Unë bisedova me Mickoskin dhe ai konfirmoi se ai do të kandidoje në zgjedhjet e 15 korrikut. E mërkura do të jetë ditë jo pune për të gjithë qytetarët. Kjo është për ta shpëtuar shtetin. Të

hënën dhe të martën do të votojnë personat e sëmurë si dhe ata që janë pozitiv me koronavirus, ata që janë në izolim dhe të sëmurët kronikë", ka thënë Zaevi.

Ajtori i kufijve tokësore, që do të hapen më 22 qershor, ka thënë se përgatitjet janë më intensive. "Ky vendim hyn në fuqi më 22 të këtij muaji, duke pasur parasysh se përgatitjet janë më intensive. Të

Mbyllt përvizitorë Galeria e Arteve e Kosovës për shkak të Covid-19

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Hapësirat e Galerisë së Arteve të Kosovës do të jenë të mbyllura pasi që dy punëtorë të stafit të këtij institucioni kanë rezultuar pozitiv me Covid-19. Galeria e Arteve e Kosovës ka

njoftuar se pas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, do të shtyhet hapja e ekspozitës "Bienalja Ndërkombëtare e Vizatimit". "Meqë në stafin e GKK-i kemi tanimë dy raste aktive me

Covid-19, sipas rekomandimit të IKShPK-së, hapësirat tona qëndrojnë mbyllur për stafin administrativ dhe teknik si dhe përvizitorë derisa të përfundojë periudha e izolimit preventiv, në fund të kësaj javë. Për

këtë arsy, hapja e ekspozitës 'Bienalja Ndërkombëtare e Vizatimit' nga AAVK shtyhet edhe për një javë dhe hapet përvizitorë të enjten e ardhshme, më 25 qershor", thuhet në njoftim.



E TË CILIN KANË FOLUR PËR PROCESET POLITIKE, PANDEMINË COVID-19 DHE RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

M NË PROCESIN E DIALOGUT ME SERBINË



Lajçaku viziton Kosovën

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka njoftuar se përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun Prishtinë - Beograd, Miroslav Lajçak, do ta vizitojë Kosovën. Sipas njoftimit, Lajçaku do të vizitojë Kosovën nga 15 deri më 18 qershor, në udhëtimin e tij të parë zyrtar nga marrja e pozitës së tij të re. "Në Kosovë ambasadori Lajçak do të takohet me udhëheqjen politike, përfaqësuesit e partive politike dhe të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, si dhe me kërret e

misioneve të vendeve anëtare të BE-së. PPBE-ja planifikon t'i diskutojë kushtet dhe modalitetet për një rifillim të shpejtë të dialogut të lehtësuar nga BE-ja mes Prishtinës dhe Beogradit", thuhet në njoftimin e Zyrës së BE-së. Po në njoftim thuhet se gjatë qëndrimit në Kosovë, Lajçaku do ta shfrytëzojë mundësinë për t'u njojur me situatën në terren. Kjo është vizita e parë e Lajçakut në Kosovë prej emëritimit të tij emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi.



Kosova aktualisht ka rreth 10 mijë teste për Covid-19

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë aktualisht ka në dispozicion rreth 10 mijë teste për sëmundjen Covid-19, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Faik Hoti, zëdhënës i Ministrisë së Shëndetësisë. Sipas tij, gjatë kësaj javë në Kosovë pritet të arrijnë edhe 10 mijë teste të tjera, ku rreth 6 500 prej tyre janë donacion nga Katari, kurse pjesa tjetër e testeve do të sigurohet nga kontraktorët e mëparshëm, e që kryesisht janë dërgesa nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania dhe Anglia. "Instituti Kombëtar ka

rreth 10 mijë teste në dispozicion, pra mjaftueshmë për t'i testuar personat me indikacione për testim, kontaktet e rasteve pozitive dhe të dyshuarit e hospitalizuar në Klinikën Infektive", ka thënë Hoti. Megjithëkëtë, vetë ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, gjatë javës së kaluar (11 qershor), në Kuvendin e Kosovës deklaroi se mungojnë teste në masë të madhe, duke shtuar se kjo ka qenë shqetësuese për të. Po të njëjtën ditë ministria e Zemajt raportoi se diaspora e Kosovës i ka dorëzuar Institutit të Shëndetit Publik të Kosovës 12 000 kite për testim. Sipas Faik



Hotit, kitet janë material që mundëson procedurën e testimit, pa të cilin nuk mund të kryhet ky proces. Duke komen-

Kosova të ketë sa më shumë teste në dispozicion për të testuar sa më shumë persona. Testi PCR (Polymerase Chain Reaction), i cili aktualisht realizohet në Kosovë, përcakton nëse virusi është aktiv, duke analizuar strishot nga hunda dhe fty. Deri më 14 qershor në Kosovë janë testuar gjithsej 18 512 persona, kryesisht kontakte të rasteve dhe prej tyre 1 486 kanë rezultuar pozitivë në Covid-19. Vetëm në tri ditët e fundit janë konfirmuar 160 raste të reja me koronavirus, nga 805 persona të testuar. Që nga fillimi i pandemisë në Kosovë kanë vdekur 33 persona me këtë virus.

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA PRITUR TË HËNËN NË TAKIM KRYEMINISTRIN AVDULLAH HOTI, MË

THAÇI E HOTI ZOTOHEN PËR BASHKËPUNI

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë zotuar se do të punojnë ngushtë me njëri-tjetrin në procesin e dialogut me Serbinë. Pas takimit të tyre të parë, ata kanë deklaruar se nuk janë në garë me njëri-tjetri se kush do ta udhëheqë këtë proces, por kanë pohuar se do të punojnë përkrah njëri-tjetrit.

Presidenti dhe kryeministri kanë vlerësuar se në këtë proces Kosova duhet të jetë e bashkuar, duke i ftuar për bashkëpunim të gjitha subjektet politike

EPOKA ERE

Muhamed KOCI

PRISHTINË, 15 JANAR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë takuar të hënën, ku kanë diskutuar për proceset politike, pandeminë Covid-19 dhe rimëkëmbjen ekonomike si dhe për procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Për këtë të fundit, ata kanë bërë me dije se Kosova në këtë proces duhet të jetë e bashkuar.

Pas takimit të parë të tyre, presidenti dhe kryeministri janë zotuar se do të punojnë bashkërisht në këtë proces. "Pikë tjetër ishte edhe koordinimi i institucioneve në rrafshin e brendshëm dhe të jashtëm, duke respektuar ligjet, me theks të veçantë përvazhdimin e dialogut. Jemi në një javë të rëndësishme përvendin, ku pritet hapja e proceseve nga ambasadori Grenell dhe vizita e Lajçakut në Kosovë", ka thënë Thaçi në një konferencë përmidie.

Shefi i shtetit éshtë zotuar për koordinim të institucioneve në këtë proces. "Duhet të koordinohemi dhe të jemi të bashkuar përvë treguar atë që duam në dialogun me Serbinë, njojhen reciproke.

Kompetencat për procesin e dialogut janë të qartësuara me Kushtetutë. Do të jemi krah përkrah me njëri-tjetrin në procesin e dialogut. Nuk jemi në garë me njëri-tjetrin, por bashkë përballe Serbisë", ka thënë Thaçi, duke shtuar se si president i vendit do të punojë përvë unifikimin e spektrit polik në këtë proces. "Do të punojmë ngushtë si president dhe kryeministër, por edhe me partitë në Kuvend, pozitë dhe opozitë. Duam njojje reciproke nga Serbia. Uroj që ky proces të jetë dinamik dhe energjik dhe Kosova nuk ka kohë të humbë me diskutime të thata", ka deklaruar ai.

Edhe kryeministri Avdullah Hoti éshtë zotuar se do të

punojë për një konsensus nacional për procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka deklaruar se éshtë i gatshëm që të takohet me secilin subjekt politik opositar përvë folur rrëth dialogut me Serbinë. "I ftoj edhe sot ata të pranojnë të takohen, të na dëgjojnë se çfarë kemi përvë thënë për procesin e dialogut. Do të mundohem të krijoj një konsensus të gjës mes forcave politike përvë këtë proces shumë të rëndësishëm", ka thënë Hoti.

Ai ka treguar se në këtë takim ia ka prezantuar edhe presidentit platformën e dialogut, të cilën e ka bërë publike ditë më parë. "Platformën që e kemi përvë dialog, e kemi bërë publike në një tryezë të organizuar nga AShAK-u. Atë qëndrim sot e prezantova edhe para presidentit dhe kërkova që plotësish të koordinohemi në këtë proces të rëndësishëm", éshtë shprehur kryeministri Hoti.

I pari i ekzekutivit ka vlerësuar se éshtë shumë e rëndësishme përvendin që në këtë proces institucionet e Kosovës të jenë të bashkuara, duke shtuar se secili institucion i ka rolet e qarta sa i përket procesit të dialogut.

Hoti ka bërë me dije se do të konsultohet edhe me anëtarët e shoqërisë civile përvë këtë



proces. "Ne i kemi rolet e ndara, por në këtë proces éshtë

e rëndësishme të jemi të koordinuar dhe të jemi së bashku. Z. Lajçak nesër do të vijë në Prishtinë, unë do të kem një takim me të përvë ta prezantuar këtë qëndrim tonin. Kam qenë në takime komplet javën. Ngadalë po formësohet dhe po unifikohet qëndrimi i të gjitha institucioneve të Kosovës karshi procesit të dialogut", éshtë shprehur kryeministri.

Presidenti dhe kryeministri i vendit gjatë takimit kanë folur edhe përvë pandeminë, duke i ftuar qytetarët që t'i respektojnë rekondimet e institucioneve profesioniste. "Kosova éshtë në drejtimin e duhur, përvë respektimin e plotë të rekondimeve të IKShPK-

së sa i përket Covid-19. Diskutuam edhe sa i përket rishikimit të buxhetit, përvë sanimin e pasojave nga pandemia", ka thënë presidenti Thaçi.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë éshtë pezulluar nga nëntori i vitit 2018, kur autoritetet e Kosovës patën vendosur taksë 100 përv qind në mallrat e Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës. Pas heqjes së masës së reciprocitetit ndaj Serbisë nga Qeveria Hoti, janë hequr të gjitha barrierat përvë rifillimin e dialogut Kosovë - Serbi.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur në vitin 2011 në Bruksel.

Thaçi: Lajçaku duhet ta kuptojë se Kosova éshtë e pavarur

Duke folur përvë vizitën që do t'i bëjë Kosovës, përfaqësuesi i posaçem i Bashkimit Evropian përvë dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, Thaçi ka thënë se ai duhet ta dijë që Kosova éshtë shtet i pavarur dhe sovran, çdo qasje tjetër éshtë dështim i tij dë BE-së në Kosovë. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë përvë liberalizim të vizave dhe jo përfjalë", ka thënë Thaçi.

Vidhet flamuri në Konsullatën e Kosovës në Kopenhangë

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Në objektin e Konsullatës së Republikës së Kosovës është vjedhur flamuri i shtetit tonë. Me këtë rast, ka reaguar Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës, duke e dënuar këtë akt vandal. "Objekti ku ndodhet Konsullata e Republikës së Kosovës në kryeqytetin


danez është sulmuar të hënën, me ç'rast është hedhur, dhe më pas edhe është vjedhur nga vandalët flamuri i Republikës së Kosovës. Bazuar në vëzhgimin e situatës nga konsulli i Kosovës në Kopenhangë, vandalizmi ishte i organizuar, pasi dorasit kishin me vete edhe mjetet e nevojshme për ta kryer vandalizmin dhe për t'iu qasur flamurit", është thënë në reagimin e kësaj ministrie. Me këtë rast, Konsullata e Kosovës ka njoftuar menjëherë policinë daneze, ndërsa Ambasada e Republikës së Kosovës ka shkruar një notë verbale për autoritetet daneze dhe ka kërkuar që sa më shpejt t'i identifikojë autorët e këtij vandalizmi dhe ata të dalin para drejtësisë.



Trusti: Nuk ka ende asnje vendim përfundimtar për tërheqjen e 10 përqindëshit

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka njoftuar se nuk ka asnje vendim përfundimtar nga qeveria për tërheqjen e 10 përqindëshit nga qytetarët. Përmes një njoftimi në rrjetin social "Facebook", ky institucion ka bërë të quartë se askush nuk ka mundësi t'i tërheqë mjetet pas pasur një vendim. "Ju njoftojmë se nuk ka ende asnje vendim përfundimtar për tërheqjen e 10 përqindëshit, andaj ende askush nuk ka mundësi t'i tërheqë mjetet nga Trusti. Ne do t'ju njoftojmë me kohë për çdo ndryshim", thuhet në njoftim. Po ashtu, ky Fond u ka bërë

thirrje qytetarëve që për shkak të kufizimeve që janë në fuqi nga pandemia e Covid-19, t'i shmangin vizitat në zyrat e Trustit për çështjen e 10 përqindëshit, pasi vështirësohet shërbimi i kontribuuesve. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti, ka planifikuar ndryshime ligjore të Trustit për tërheqjen e 10 përqindëshit të kontributave pensionale para moshës së pensionit. Hoti, në programin qeverisës, në një nga masat e pakos së rimëkëmbjes ekonomike ka paraparë ta fusë në ekonomi një përqindje të këtij fondi.



Këngëtarët kërkojnë që të lejohet organizimi i dasmave



PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armand Zemaj, ka pritur në takim një grup të këngëtarëve dhe përfaqësuesit e bizneseve të sallave të dasmave, të cilët të hënën kanë protestuar para objektit të qeverisë për moslejimin e organizimit të dasmave. Këtë grup të protestuesve e përbën këngëtarët Afrim Muçiqi e Labinot Tahiri - Labi, përfaqësuesit e bizneseve të sallave të dasmave, gastronomisë, dekorave dhe të bizneseve që lidhen me organizimin e dasmave. Zemaj ka thënë se nëse do të respektohet "Manuali për mbrojtje nga përhapja e virusit

Covid-19" sërisht ditëve në vazhdim do t'i takojë përfaqësuesit e sallave të dasmave për t'i diskutuar kërkosat e tyre dhe së bashku t'i ndërmarrim hapat e mëtutjeshëm, gjithnjë sipas rekomandimeve të IKShPK-së. "Jam kundër çdo zgjidhje selektive për bizneset dhe se s'do të ketë rikthim të gjendjes së mëparshme. Sikurse jam i gatshëm që 24 orë në ditë të mbajë derën e hapur për përfaqësuesit e bizneseve të sallave të dasmave, që këta t'i shohin angazhimet maksimale që po bën ministria në luftën kundër Covid-19", ka thënë Zemaj.

Rektorit Bajram Kosumi i jepet çmimi "Idriz Seferi"

GJILAN, 15 QERSHOR (ER) - Në kuadër të shënimit të ditëve të çlirimt të Gjilanit, kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ia ka dhënë çmimin "Idriz Seferi" rektorit të Universitetit të Gjilanit "Kdri Zeka", Bajram Kosumi, në nderim të kontributit të dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

"Sot më mirë se asnjëherë i kuptojmë motivet e Kadri Zekës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës, Agim Ramadani, Isa Kastratit, Abdullah Tahirit e heronjve tanë të tjera, të cilët e flijuan veten për lirinë e Kosovës. Me z. Haziri kemi bërë një pjesë të rëndësishme të rrugës përgatitjen e Kosovës për



Prezantohet manuali për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19

Kosova mund të përfshihet nga vala e dytë e infektimeve me Covid-19

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka prezantuar të hënën manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19. Ai ka thënë se manuali përmban udhëzues të hartuar nga fusha të ndryshme të cilët paraprakisht janë analizuar dhe vlerësuar nga profesionistët shëndetësorë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publik të Kosovës të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërkaq kryeministri Avdullah Hoti ka thënë Kosova mund të përfshihet nga vala e dytë e infektimeve me Covid-19. Kurse drejtori ekzekutiv i IKShPK-së u ka bërë apel qytetarëve dhe subjekteve që t'i zbatojnë rekomandimet



EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka prezantuar të hënën manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19, i cili ka për qëllim mbrojtjen e qytetarëve nga përhapja e infeksionit me Covid-19 në Kosovë. "Manuali i përgatitur është një dokument dinamik i cili do të përditësohet varësish nga situata epidemiologjike dhe vlerësimi i rezikut. Manuali përmban

udhëzues të hartuar nga fusha të ndryshme të cilët paraprakisht janë analizuar dhe vlerësuar nga profesionistët shëndetësorë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë", ka thënë ministri Zemaj në një konferencë për media. Ai ka theksuar se manuali është përgatitur në bazë të njojurive ekzistuese në lidhje me sëmundjen e koronavirusit 2019 dhe duke shfrytëzuar udhëzimet e institucioneve më të

besueshme si OBSh dhe CDC. "Ky manual i përkohshëm mund ta ndihmojë parandalimin e ekspozimit në Covid-19 dhe përmban udhëzime për në vendet e punës; për mjedise jomjekësore; për qendrat tregtare dhe gastronominë; për pasagjerët dhe personelin e avacionit civil; për udhëtimet zyrtare; për grupet vulnerable (grupet e ndjeshme); udhëzime për vendvotimet si dhe shumë udhëzime të tjera të dobishme për qytetarët dhe veprimtaritë e liruara si dhe për veprimtaritë që do të lironen në të ardhmen. I njëjtë do të shërbejë si dokument mbështetës i organeve mbikëqyrëse (inspektoratet) të autorizuar nga MSh dhe IKShPK, për ta mbikëqyrur zbatimin e rekomandimeve të përfshira në këtë manual", ka theksuar ministri Zemaj.

Ai ka thënë se të gjitha institucionet respektive obligohen t'i zbatojnë masat e përcaktuara në këtë manual, varësish nga specifikat e tyre.

"Ministria do ta ndaj këtë manual me të gjitha institucionet qendrore dhe ato lokale si dhe me publikun, me

qëllim që ta përdorim të gjithë si

një instrument për mbrojtje nga përhapja e mëtejme e pandemisë Covid-19. Ne besojmë se zbatimi i masave të ndërmarrë nga qeveria dhe rekomandimet e IKShPK-së do të në mundësijnë që ta kontrollojmë shpërthimin e Covid-19 dhe në këtë aspekt, të gjitha pjesët e shoqërisë, përfshirë bizneset dhe punëdhënësit, duhet t'i luajnë rolet e tyre nëse duam ta ndalojmë përhapjen e kësaj sëmundje", ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka thënë se manuali si dokument do të përditësohet në vazhdimësi dhe nga konferanca pati një porosi të quartë për qytetarët dhe bizneset.


"Ne nuk jemi në asnje mënyrë që të kthehem prapa me masa, por që të mos ndodhë kjo, duhen zbatuar masat e MSh-së dhe rekomandimet e IKShPK-së. Përdoren manualin, bartni maska, mban distancën dhe mirëmbani higjienën. Këto janë armë të thjeshta, por shpëtojnë jetë", ka pohuar Zemaj.

Drejtori ekzekutiv i IKShPK-së u ka bërë apel qytetarëve dhe subjekteve që t'i zbatojnë rekomandimet sepse, siç ka vlerësuar ai, deri tash ka

dështuar implementimi i masave mbrojtëse nga qytetarët. "Nëse situata shkon duke u përkëqësuar si pasojë e mospërgjegjësisë për t'i zbatuar masat, do të detyrohem i intervenojmë për t'i kthyer masat në pikën zero, si profesionistë shëndetësore nuk mund të lejojmë të vdesin njerëz nga papërgjegjësia e të tjerëve", është shprehur profesor Ramadani.

Sa iu përket testeve, ai tha se për momentin në Kosovë janë duke u kryer teste me metodën RT-PCR, ndërsa më tej do të vendoset bashkë me MSh-në për teste serologjike apo edhe për teste serologjike në fazat e mëtejme.

Ndërkaq në një deklaratë për media kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se vendi ynë mund të përfshihet nga vala e dytë e infektimeve me virusin Covid-19. "Në bazë të trendit të ditëve të fundit me raste të reja të infektimeve, ky rrezik është shumë real. Mund të preken edhe më shumë jetë njerëzish, do të thellohet kriza ekonomike, ndërsa do të stërngrarkohet sistemi i shëndetësisë", ka thënë Hoti.



Kryeministri i Bullgarisë dhe ai i Kuvajtit urojnë Hotin

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pranuar urime nga kryeministri i Republikës së Bullgarisë, Boiko Borisov dhe ai i Kuvajtit, Sabah Khaled Al-Hamad Al-Sabah, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të ekzekutivit. "Në emër të qeverisë bullgare dhe në emrin tim po ju dërgoj përgëzimet e mia më të përzemërtë dhe urimet e mia me rastin e zgjedhjes suaj për kryeministër të Republikës së Kosovës dështuar implementimi i masave mbrojtëse nga qytetarët. "Nëse situata shkon duke u përkëqësuar si pasojë e mospërgjegjësisë për t'i zbatuar masat, do të detyrohem i intervenojmë për t'i kthyer masat në pikën zero, si profesionistë shëndetësore nuk mund të lejojmë të vdesin njerëz nga papërgjegjësia e të tjerëve", është shprehur profesor Ramadani.



kabinetit tuaj nga ana e Kuvendit. Besoj se marrëdhëniet e mira në mes të dy shteteve tonë do të vazhdojnë të zhvillohen edhe më tutje për aktivizimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Do të gëzohem nëse në të ardhmen e afërt do të kemi mundësi t'i diskuto-

jmë këtë perspektiva", ka thënë kryeministri i Bullgarisë në urimin e tij dërguar Hotit.

Kryeministër i Kuvajtit, Sheik Sabah Khaled Al-Hamad Al-Sabah, ka thënë se do të punojnë për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. "Kemi kënaqësinë t'i përcjellim shkëlqesinë suaj urimet më të sinqerta dhe përshtëndetjet më të mira, me rastin e formimit të qeverisë së re, të vendit mik, Republikës së Kosovës, duke ju uruar suksese në përm-

bushjen e detyrës suaj, në funksion të shpresës dhe aspiratave të popullit të Republikës së Kosovës. Përfitoj nga rasti t'i vlerësoj marrëdhëni shumë të mira dypalëshe që lidhin dy vendet tona, duke shprehur sigurinë tonë për forcimin e tyre, në të mirë të dy popujve tanë miq. Urime të singerta dhe, përshtëndetjet më të mira për shkëlqesinë tuaj, shëndet të plotë, e popullit tuaj mik zhvillim e prosperitet të mëtejshëm", thuhet në urimë kryeministrat të Kuvajtit.

Kosnetti premton mbështetje për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett. Ministrja Bajrami e informoi ambasadorin Kosnett rreth aktiviteteve të Ministrisë së

Financave sa i përket menaxhimit të financave publike dhe projekteve të tjera të rëndësishme në funksion të ruajtjes së stabilitetit makro-fiskal në vendin tonë. Ajo ka folur për procesin e rishikimit të buxhetit të Kosovës i cili është në fazën përfundimtare dhe që së shpejti do të dërgohet

për aprovim në qeveri e pastaj në Kuvend.

Bajrami vuri në pah se buxheti i rishikuar do ta mbulojë financimin e plotë të pakos emergjente fiskale dhe do ta përfshijë financimin e një programi të rëndësishëm përimëkëmbje ekonomike si

përgjigje ndaj dëmeve ekonomike e financiare të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Ambasadori Kosnett ka uruar ministren Bajrami përmarrjen e detyrës së re, njëkohësisht ka shprehur gatishmërinë e Ambasadës Amerikane për ta

mbështetur Ministrinë e Financave dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës përvazcimin e proceseve që kanë të bëjnë me rimëkëmbjen ekonomike, fuqizimin e institucioneve dhe përparimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.



Ministri Reçica premton rritje të pensioneve bazë për të moshuarit



PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, të hënën në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Parandalimin e Abuzimit ndaj të Moshuarve, ishte përvizitë në

Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë, shtëpi në të cilën janë të sistemuar mbi 70 persona të moshuar.

Gjatë kësaj vizite në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë ministri Reçica theksoi se "ne si shtet dhe shoqëri duhet të bëjmë akoma më shumë për këtë kategori të qytetarëve dhe pikërisht kjo ishte

arsye e kësaj vizite, pra për ta shprehur gatishmërinë e tij dhe të dikasterit që drejtont për ta bérë më të mirën e mundshme që këta bashkëqytetarë të kenë kushte dhe shërbime sa më të mira jetese". "MPMS-ja në koordinim me institucionet e tjera gjegjëse është duke u kujdesur që ta sigurojmë buxhetin e nevo-

jshëm përgjithë të moshuarit që janë të përfshirë nëpër skemat pensionale dhe sociale dhe, po ashtu, të sigurojmë shërbime adekuate në qendrat e të moshuarve", ka theksuar ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica.

Ai ka premtuar për të ardhmen rritje të pensionit bazë për të

moshuarit në Kosovë. "Do t'i shikojmë mundësitë që ai pensionbazë në të ardhmen të jetë më i lartë sesa që është tan. Do të shikohen të gjitha mundësitë që t'u krijojmë kushte në aspektin buxhetor, që të paktën pensioni bazë që quajmë ne të jetë në gjendje tjetër sesa që është tan", ka deklaruar ministri Reçica.

Mbahet mbledhja e pestë e Qeverisë së Kosovës

Qeveria miraton planin e punës

Në mbledhjen e së hënës Qeveria e Kosovës ka miratuar planin e punës së qeverisë për vitin 2020 dhe planin indikativ të punës së qeverisë për vitet 2021 dhe 2022. Po në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar është miratuar edhe Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar të hënën mbledhjen e pestë të rregullt, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar vendime dhe politika të fushave të saj të përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore.

Vendimi i parë i aprovuar i kabinetit qeveritar në këtë mbledhje ka qenë miratimi i Planit të Punës së Qeverisë për vitin 2020 dhe Planit Indikativ të Punës së Qeverisë për vitet 2021 dhe 2022. Plani bazohet në Programin Qeverisës 2020-2023 dhe ka identifikuar të gjitha veprimet dhe aktivitetet e institucioneve qeveritare për zbatimin e tij.

Pjesë e këtij plani të aprovuar janë edhe: Plani legjislativ 2020, Plani i dokumenteve strategjike dhe Lista e koncept-dokumenteve për politikat qeveritare që planifikohen gjatë vittit 2020.

Në vazhdim të mbledhjes, kabineti qeveritar ka aprovuar planin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2021, me sugjerimin që Agjencia e Statistikave të Kosovës t'i

harmonizojë implikimet financiare të këtij plani me Ligjin për Buxhetin e viti 2021.

Ajencia e Statistikave të Kosovës, gjithashtu, është obliguar për zbatimin e këtij plani. Plani synon realizimin e objektivave të identikuara në Programin e Statistikave Zyrta 2018-2022 dhe ka për objektiv kryesor krijimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor, zgjerimin e prodhimeve dhe hulumtimeve të reja si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave zyrtare. Agjencia e Statistikave të Kosovës synon edhe shkurtimin e afateve në procesin e prodhimit, me qëllim të ofrimit të dhënavë zyrtare të shfrytëzuesit në kohën më optimale të mundshme.

Është miratuar edhe Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive.

Me këtë rregullore zëvendësohen shtojcat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me shtojca të reja, me



pak ndryshime nga shtojcat e kaluara. Ndryshimet janë bërë me qëllim të qartësimit të përgjegjësive të ministrive në fjalë në fushat specifike siç janë: ndërmarrësia dhe inovacioni në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit; investimet strategjike që ndërlidhen me diasporën në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; inovacioni shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si dhe investimet e huaja dhe investimet strategjike mbesin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në vazhdim të mbledhjes është miratuar edhe rregullorja përfaktorët e dozave dhe mbrojtjen nga rrezatimi. Kjo rregullore përfaktorët e dozave përkufizimet e profesionale, publike dhe mjekësore; kufijtë e dozave për punonjësit e eksposuar, praktikantët, studentët dhe punëtorët e jashtëm të angazhuar në situata emergjente; si dhe nivelin e kufijve të radonit në

vendet e punës. Kabineti qeveritar ka konfirmuar vullnetin për vendimet e qeverisë që kanë mbetur në procedurat e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qeveria rekomandon që të procedohen tutje për shqyrtim në procedurat e Kuvendit: Raporti i Statistikave Zyrta për vitin 2019 dhe raporti tremujor financiar për vitin 2020, ndërsa të tërhiqen nga procedurat e Kuvendit Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit 2020-2024. Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin e miratuar në këtë mbledhje, i ka rekomanduar presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë ministrin e Financave për nënshkrimin e marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për financimin e "Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën". Në parim është aprovuar edhe

vendimi për nismën e miratimit të "Protokollit numër 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda CEFTA-s".

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të zhvillojë këto negociata në kuadër të Marrëveshjes për ndryshimin dhe aderimin në Marrëveshjen për Tregt të Lirë në Evropën Qendrore.

Synimi i këtyre marrëveshjeve është zgjidhja e kontesteve tregtare midis vendave nënshkruese dhe do të jetë pjesë integrale e Marrëveshjes së CEFTA-s.

Ka marrë miratimin nga Qeveria e Republikës së Kosovës edhe vendimi për nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare trepalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufirit.

Marrëveshjen në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës do ta negocjojë Ministria e Punëve të Brendshme. Marrëveshja synon shkëmbimin e informatave dhe rritjen e kontrollit të kalimit të lirë të kufirit në funksion të luftimit të kontrabandës dhe migrimit ilegal. Kryeministri Avdullah Hoti ka kërkuar që të hartohen rregulloret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendave të punës brenda se cilës ministri si dhe ka paralajmëruar që sot (e martë) kabineti qeveritar do të diskutojë Projektligjin përrishimin e buxhetit për vitin 2020.

Kryeministri Hoti ka bërë me dije se duhen deri në 700 milionë euro për ta krijuar fondin përimëkëmbjen ekonomike.

Uljini është bërë gati për t'i pritur qytetarët e Kosovës

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ulqini është bërë gati për t'i pritur vizitorët nga Kosova e të gjithë ata që do t'i kalojnë pushimet në këtë vend do të kenë çmime më të volitshme sesa në vitet e tjera. Ulqini këtë vit do t'jetë më i lirë dhe do t'ketë një zbritje prej 20 përqindësh të çmimeve për turistët nga Kosova.

Zyrtarët e Komunës së Ulqinit të hënën në Prishtinë kanë prezantuar ofertat turistike për sezonin 2020 ku, ndër të tjera, u tha se Ulqini është një vend i sigurt nga virusi Covid-19, pasi nuk ka raste të reja.

Kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq, u shpreh se i kanë marrë të gjitha masat për t'i mbrojtur pushuesit nga virusi Covid-19, ku tha se distanca

sociale do të respektohet në të gjitha plazhet e Ulqinit. Ai ka thënë se 20 për qind do të ketë lirime për turistët që shkojnë në Ulqin për t'i kaluar pushimet, derisa ka shtuar se nuk kanë pengesa as në kufi. "U kemi rekomanduar të gjithëve atyre që merren me turizëm, që t'i zvogëlojnë dhe të japid zbritje të gjithë vizitorëve që vijnë nga Kosova, mirëpo nuk jemi ne me shkop magjik që t'u themi ulni çmimet. Vullneti i gjithë atyre biznesmenëve të cilët merren me turizëm, besoj se kanë sens dhe do t'i ulin çmimet më pak se vitin që kemi lënë pas. Siguria në Ulqini është shumë më e madhe", ka thënë ai.

Ndërsa ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinoša, ka pohuar se Ulqini edhe këtë vit do t'i presë duarhapur qytetarët e Kosovës që do ta vizitojnë këtë



vend, ndërsa u shpreh se Mali i Zi do ta ndihmojë Kosovën edhe në fushën e integrimeve evropiane. "Mali i Zi do të jetë i gatshëm meqë është para Kosovës në disa aspekte, sidomos në aspektin e integrimit evropian dhe të atij euroatlantik. Mali i Zi nuk do ta kursejë ndihmën e vet në këtë drejtim

dhe në të gjitha drejtimet e tjera jo vetëm për Kosovën, po për të gjitha shtetet fqinje që kanë nevojë për këtë. Unë jam i sigurt se Ulqini edhe sivjet në kushtet e pandemisë vërtet pas pandemisë do t'ju pres duarhapur e zemërhapur", është shprehur ambasadori Dinoša. Ndërsa ushtruesi i detyrës së

sekretarit të përgjithshëm të MTI-së në Kosovë, Irfan Lipovica, ka theksuar se i mirëpresin qytetarët e Ulqinit që ta vizitojnë Kosovën.

Ndërkohë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se Covid-19 po lë efekte të shumta në ekonominë e Kosovës, ku ka theksuar se ka rënje të hyrave dhe rënje të aktivitetit ekonomik. Sipas tij, shumë biznese nuk do të arrijnë të marrin vete shumë shpejt, për çka ka kritikuar Qeverinë e Kosovës që, sipas tij, deri më tash ka qenë e ngathët për t'i ndihmuar bizneset.

Në këtë takim janë paraqitur edhe ofertat nga hotele të ndryshme, e të cilët kanë deklaruar se i kanë marrë të gjitha masat për t'i mbrojtur turistët nga Covid-19.

Haziri: Ditët e bardha të lirisë kulmojnë më 25 qershori kur do të kthehet në bronz Abdullah Tahiri

GJILAN, 15 QERSHOR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë nisur të hënën aktivitetet e shumta në shënim e 15 qershorit, Ditës së Çlirimit të Gjilanit, me një pjesëmarrje të gjitha institucioneve në nivel lokal e regional, përfshinë përfshinë respektin dhe nderimet për heronjtë e kombit. Sot në këtë ditë do të bëhet parakalimi në shenjë falenderimi përmjekët dhe institucionet komunale e regionale të cilët kanë luftuar përhapjen e Covid-19 si institucione që nuk ndalen në asnjë moment përmët e ndihmuar dhe lehtesar jetën e qytetarëve. Ndërkohë, më 25 qershori përfundojnë aktivitetet, kur edhe do ta sjellim lapidarin e Avdullah Tahirit, Hero i Kombit, që ky vit i përkushtohet atij,

gjithë qytetarët e Gjilanit. Për shkak të pandemisë, festa do të shënohet me aktivitete ceremoniale dhe programe kulturore online, që përfshinë respektin dhe nderimet për heronjtë e kombit. Sot në këtë ditë do të bëhet parakalimi në shenjë falenderimi përmjekët dhe institucionet komunale e regionale të cilët kanë luftuar përhapjen e Covid-19 si institucione që nuk ndalen në asnjë moment përmët e ndihmuar dhe lehtesar jetën e qytetarëve. Ndërkohë, më 25 qershori përfundojnë aktivitetet, kur edhe do ta sjellim lapidarin e Avdullah Tahirit, Hero i Kombit, që ky vit i përkushtohet atij,



veprës dhe kontributit në rreshtin e gjatë të heronjve dhe dëshmorëve të Kosovës të rënë përliri", ka thënë Haziri. Ai ka apeluar që të festohet, por

Kurteshi-Emini, ka uruar të gjithë qytetarët e kësaj komune për Ditën e Çlirimit. "Kjo ditë është histori e lirisë dhe nuk do të harrohen asnjëherë ato çaste. Është një ditë e bardhë e kujtimit përmët e gjithë ata që dhanë gjithçka nga vetja e tyre, edhe jetën, që ne sot të jetojmë të lirë e të zhvillohem. Kemi obligim të gjithë së bashku që të punojmë përmët ruajtje të paqes dhe të kontribuojmë përmët një Kosovë siç e deshën ata", ka thënë Kursteshi-Emini.

Në anën tjetër, Ahmet Isufi, ish-komandant i Zonës Operative të Karadakut, ka kërkuar të mos harrohet asnjëherë gjaku i dergjor përliri.

Shtabi emergjent në Mitrovicë kërkon respektimin e masave kundër Covid-19



Mitrovicë, 15 qershori (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur të hënën mbledhjen me shtabin emergjent të Komunës së Mitrovicës, ku është diskutuar lidhur me gjendjen aktuale dhe zbatimin e masave preventive ndaj virusit Covid-19.

Fillimisht drejtoresha e Institutit Rajonal të Shëndetit Publik në Mitrovicë, Teuta Fejza, ka potencuar se deri më tanë në këtë komunë janë realizuar mbi 400 testime përmët personat e dyshuar me Covid-19 dhe raste kontakti dhe se pas rezultateve pozitive të dy-tri ditëve të fundit, janë gjurmuar dhe identifikuar gjithsej 47 raste kontakti dhe raste me simptome.

toma të cilat janë dërguar përmët testim në IKShPK, me ç'rast sonte pritet të dalin rezultatet e tyre. Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, ka raportuar përmët situatën aktuale në institucionet shëndetësore, derisa ka theksuar se stafi është i gatshëm të ofrojë shërbime të sigura dhe profesionale përmët qytetarët dhe se Komuna e Mitrovicës të gjithë personave që kanë qenë dhe janë në vetë izolim u ka dalë në ndihmë me pakos ushqimore, higjenike dhe pakos mjekësore. Në këtë mbledhje anëtarët e shtabit emergjent komunal janë pajtuar që të zbatohet Rregullorja Komunale Nr. 03/2014 përmët cak-

timin e orarit të punës përmët subjektit afarisë që veprojnë në Komunën e Mitrovicës dhe se Drejtoria e Inspeksionit, në bashkëpunim me Policinë Rajonale, do të kryejnë inspektimet e vazhdueshme në mënyrë që të zbatohet kjo rregullore. Njëkohësisht është bërrë me dije se do të merren masa shtesë përmët qytetarët që frekuentojnë objektin e Komunës së Mitrovicës. Në fund, anëtarët e Shtabit Emergjent kanë bërrë apel te gjithë qytetarët që ta vazhdojnë kujdesin ndaj këtij koronavirusi, duke përdorur masat mbrojtëse dhe duke shëmangur ambientet e mbyllura dhe shumë të frekuantuara.

Kastrati falënderon mjekët dhe infermierët vullnetarë përmët punës e tyre në pandemi

KAMENICË, 15 QERSHOR (ER) - Mjekët dhe infermierë, të cilët kanë diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, e që përmët momentin janë të papunë, kanë shprehur dëshirë dhe vullnet që t'i dalin në ndihmë stafit shëndetësor të Komunës së Kamenicës. Kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, duke falënderuar të gjithë këta vullnetarë përmët punës e tyre, ka thënë se është shumë krenar se, përvèç profesionalizmit në punë, ata janë edhe humanë. "Mjekë deh infermierë, vullnetarë në pikën kufitare. Këta janë doktorët e infermierët vullnetarë që po i dalin në ndihmë stafit mjekësor të QKMF-së në pikën kufitare 'Dheu i Bardhë'. Disa në ndërrim të mëngjesit e disa në atë të natës, por gjithmonë plot vullnet e energji përmët punës. Po e ritheksoj edhe një herë që jam shumë krenar me kuadrot e

Kamenicës sepse, përpos profesionalizmit, janë humanë e solidarë. Shqiponjë, Fisnik, Erolind, Vlerë, Granit, Qendrim, Qemajl, Edonis, Blinerë e Jetmir, faleminderit përmët kontributin që jepni në këtë periudhë pandemie, pa kërkuar asgjë në këmbim", ka thënë ai, duke u bërë thirrje qytetarëve që ta vazhdojnë kujdesin përliri, rrëthim dhe familjet e tyre.



Mërgimtari Hasim Mazreku ndihmon QKMF-në 'Shpëtim Robaj'



MALISHEVË, 15 QERSHOR (ER) - Mërgimtari Hasim Mazreku nga Komuna e Malishevës, i cili punon në Bremen të Gjermanisë, njihet si humanist i madh. Kësaj radhe, sikur edhe më parë, ai ka ndihmuar shumë institucione sportive e klube të futbolit, me topa e ndërresa si dhe mjetet e tjera si dhe ka sjellë karroca përmët nevojat e personave me nevoja të veçanta, ndërsa të hënën ka ndihmuar me patricëa Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Shpëtim Robaj" në Malishevë. Këtë dona-

cion e ka pranuar drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Liridon Hoti dhe drejtori i QKMF-së, Nuhi Moria. Hoti dhe Morina kanë falënderuar donatorin Hasim Mazreku përmët ndihmat në vazhdimesi dhe përkujdesjen përmët nevojat e QKMF-së. "Kjo ndihmë me këto mjete do t'u shërbëjë qytetarëve të cilët do ta kenë nevojën e përdorimit të tyre si dhe përmët institucionin kjo ndihmë është më se e duhur, në kohë të duhur, prandaj po dësh-

mohet se mërgimtarët tanë, kur është në pyetje vendlindja dhe qytetarët e institucionet e saj, gjithherë e kanë ndihmuar dhe do ta ndihmojnë edhe në të ardhmen", ka njoftuar Komuna e Malishevës. Sipas këtij njoftimi, Hasim Mazreku ka thënë se do të angazhohet në vazhdimesi që ta ndihmojë edhe më tutje Komunën e Malishevës. "Do të organizohem edhe më shumë në mërgim dhe do t'i dalim në ndihmë, Malishevës dhe qytetarëve tanë, në shumë kërkesa të tyre", ka thënë Mazreku.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (7)

BACA SHABAN DHE DJEMTE



Bedri ISLAMI

Trungu i Familjes është Shaban Jashari. Nëpër këtë trung kanë hapur degët e tyre djemtë, nipay e mbesat. Asnjëherë nuk kanë qenë më të shumtë. Asnjëherë nëpër shkallët e kullave nuk kanë lëvizur më shumë njerëz. Shaban Jasharit i gëzohet zemra për njerëzit që lëvizin, për jetët që bulojnë, zemra që ka qenë e qetë për gjithçka, nuk ngihet nga zërat e nipërvë e mbesave.

Meraku i vetëm i Shaban Jasharit është të rrosh si duhet.

Të rrosh si duhet për Shaban Jasharin do të thotë të jesh i ndershëm deri në skaj, të provosh gjithçka, edhe të mirën, edhe të keqen dhe që të dyja në shfaqjen e tyre më të thekshme. Dhe ai i ka provuar të dyja deri në plotësi. E keqja ka qenë e skajshme, por nuk e ka thyer. Të mirat kanë ardhur të bollshme, por nuk e kanë ndërruar. E keqja i ka ardhur prej larg, të mirën e ka ndërtuar vetë. Të keqes i ka thënë plaç, të mirën e ka ndarë me shokë e dashamirë. Edhe kur ka qenë i intuem, zemrën e ka pasur plot. Edhe kur e ka parë veten një hap larg vdekjes, ka ditë të dallojë jetën. Ka ndjekur Shaban Polluzhën në rininë e tij, sepse e ka ditur se kjo rruga e nderit. Ka pranuar të vuajë më mirë ai vetë dhe robërit e shtëpisë së tij, se sa të vuajë dikush tjetër përfajin e tij. I njeh urat e bashkimit të njerëzve, ndoshta më mirë se askush tjetër, por kurrë nuk është bërë urë për ta shkelur të tjerët. E do Prekazin e Poshtëm më shumë se sa lagjen e Jasharëve, por mbi Prekazin ka Drenicën, dhe mbi Drenicën ka Kosovën. Djemtë e vajzat i mëson ta duan Shqipërinë, nipërit e mbesat i nis për atje.

Shaban Jashari është një njeri që nuk ngutet. Ka fituar në këtë jetë përvojë të bollshme, ajo rrjedh në venat e tij, i di punët më mirë se të tjerët, e di se vjen dita e ndeshemi me serbin, por pa u ngut, jo për ta filluar sot e për ta lënë nesër.

Më 30 janar 1991 baca Shaban qëndron tërë kohën në kullë me njerëzit e shtëpisë. Policia vjen e përforcuar me mjete të tjera luftarakë: helikopterë, tanke, qen të ushtrisë dhe futen turashëm në oborrin e shtëpisë.

Njëri prej kryeoficerëve të polisë serbe e pyet bacën Shaban:

- Të kujt janë këto shtëpi dhe

pasuri?"

- Të miat dhe të djemve dhe të nipave të mi, ia kthen Shaban Jashari.

- A kanë mend këto djemtë e tu që po luftojnë, kur i kanë të gjitha këto të mira?

- Po, i kanë të gjitha, veç liri nuk kanë - ia kthen baca Shaban.

Në të vërtetë kjo është edhe deviza e tij. Për këtë u hap rrugë djemve, megjithëse e di se është një rrugë e vështirë. Shkon edhe më tej se kaq, u ndihmon në këtë rrugë. Me të gjitha. Dhe kur duket se e gjithë ajo që kishte bërë nuk do të ishte e mjaftueshme, lufton krah tyre. Do të jetë njëri ndër pjesëtarët e familjes që u bën ballë tri rrithimeve të kullave të tyre.

Jasharët, të gjithë, e adhuronin babën e gjyshin e tyre. Do të ishte deri në fund njëri nga vendet e shenjta, të cilit i faleshin dhe e kishin të vyer fjalën e tij. Do të merrnin me vete qetësinë e tij të jashtëzakonshme, qëndrimin stoik, fjalën e mençur dhe në kohën e duhur, respektin përmikun dhe për kalimtarin e zakonshëm, do të dinin të dallonin se përbimi pamjen e tij të jashtme, në dukje të ftohtë, ishte një zemër që i miklonë edhe kur ishin bërë vetë prindëri. Shaban Jashari i ka të fuqishme pasionet që kanë lidhje me kombin e tij, ata janë pjesë e vlerave dhe e virtuteve të tij, deri sa bëhen pjesë e të gjithëve.

NËNA E SHTËPISË, REJAT DHE BIJAT

Nëna e shtëpisë quhej Zahide, por nipërit e mbesat, në shenjë dashurie dhe shkurt, i thoshin gjyshja Zade. Djemtë e thërrisin loke, nuset e shtëpisë e thërrisin nanë. Ishte njëra nga mbesat e Shaban Polluzhës, dhe kur e kishin fejuar me Jasharët kishin pasur parasysh, të dyja palët, të bënин një miqësi të mirë. Jasharët thoshin asaj kohe, thonë edhe tani, "Mos merrni çfarëdo miku, sepse po more ndonjë mik që nuk është bimë e shëndoshë, të tillë do të janë edhe nipat e mbesat".

Nëna Zadja, le ta quajmë kështu,

nuk ishte nga bimët e

zakonshme, ajo ishte nga

trungjet e lista të familjeve të

Kosovës dhe me vete solli

blerimin e këtij lisi.

E shkurtër në trup, me shikimin e butë, dashamirës, ajo rezatonte vetëm mirësi. E gjithë qenia e saj ishte e tillë, e ngritur mbi një strukturë të fuqishme njerëzore, të cilat, vitet që shkojnë, sado të dhimbshme të janë, nuk do të mund t'i shpërfytyrojnë. Ajo lëviz ngadalë nëpër shtëpi, është e para që

ngrihet dhe shkon të flejë kur

gjithçka është në vendin e saj.

Nuk i ndan rejat nga bijat, nuk i ndan nipërit nga mbesat, e shikon e ngazëlluar se më të rinjtë po lidhen fort me zakonet e fisit dhe me burrin e saj, e ndjen se kjo është për mirë dhe nuk ka asnje lloj derti për të ardhmen e tyre. Nuk ka bërë kurrë hesape në jetën e saj me të ardhmen e familjes. E dëgjon të shoqin kah u thotë njerëzve të shtëpisë që dy gjëra e mbajnë njeriun e fortë, morali dhe moslakmia, dhe ndjehet edhe më e sigurt për ata që do të lerë pas; kanë moral të lartë e nuk kanë lakmi. E ndjen mallin për djemtë, kur nuk i ka në shtëpi, dhe i mbushet

thotë kurrë "jo", mirëpo gjithmonë e ka me vete merakun e nanës, por një merak që e mban për vete deri në çastin e fundit.

Nisin demonstratat e mëdha të vitit 1989, është kohë e ftohtë, mot i rënduar nga erërat dhe bornat dhe klimë e ashpër politike nga regjimi i Milosheviqit. Viti 1989 do të jetë viti i parë i sprovës me pushtimin e ri. Në ballë të provës do të vihen disa djem të rinx, shumë nga të cilët do të janë të lëvijzeve ilegale çlirimtare. Turmat e njerëzve, disa mijëshe, nisen drejt Prishtinës. Njerëzit nisen nga Skenderaj drejt Prishtinës,

Një ngjarje:

Në fundin e rrethimit të parë të Jasharëve, kur tre djemtë e Familjes tërhiqen dhe zënë vend në Kodrat përballë, të gatshëm për t'i shkuan luftës deri në fund, policët serbë marrin peng 27 anëtarë të Familjes, së bashku me tre nipa, të cilët kishin qëlluar atë natë në shtëpi, ndërsa të gjithë meshkujt, prej Fitimit e lart, pra, të gjithë ata që i kishin mbi 13 vjet i lidhin dhe i nxjerrin me duar të lidhura përjashta në borë, para tankeve.

Policët serbë e qesin po ashtu nanën e djemve si mburojë para tyre, duke dashur të hyjnë në shtëpi, sepse kishin menduar se Ademi ishte brenda. Strukeshin prapa shpinës së saj dhe në duar mbanin automatikët. Nana po i thotë njërit prej policëve:

- Hiqmu qafe more qen, çka po fshehësh pas meje?"

- Kam frikë se njëri prej djemve është brenda e po më vret.

- Kur frikësohesh dhe nuk ta mban, pse ke ardhur në Prekaz? - thotë nana policit serb.

Sa herë që më bien rasti ta rishikoj në mesin e djemve të saj, në filmimet e kohës që janë bërë, me mbesin sytë në shkëlqimin e syve të saj, në atë dritëzim të veçantë që marrin ata kur është aty, pranë tyre, e lumtur dhe e trazuar njëkohësisht, por, gjithsesi, nga ajo e ndjen që buron ndjenja e së mirës, e së drejtës dhe e mbështetjes.


Dhe kur djemtë marrin nga nana e tyre të mirën, të drejtën dhe mbështetjen, atëherë...

Asgjë në rrëfimin për Jasharët nuk do të ishte e plotë në se nuk do të ishte pjesë edhe ajo që ka lidhje me rejtat dhe bijat e kësaj familje. Megjithëse në

pamjen a parë do të mund të dukej se nën strehën e këtyre kullave gjendej një familje e madhe patriarkale, e vërteta do të jetë krejt ndryshe.

Do të jetonin mrekullisht me njëra tjetërën e drejta zakonore dhe koncepti i një jete të ngritur mbi realitetin e një jete të re, do të ishin të pranishëm forca e fjalës së burrit dhe fisnikëria e fjalës së gruas, dhe kufiri mes njërisë dhe tjetës do të ishte krejt i padukshëm. Nën atë strehë të madhe nuk kanë jetuar asnjëherë qenë të ndrydhura apo të shtypura, në të kundërtën, pas pamjes së jashtme, që nuk ishte edhe aq e vërejtur, ka jetuar një familje e madhe, e zakonshme për traditën drenicase, në të cilën gjithkush kishte vendin e tij, por njëkohësisht kishte edhe të përbashkëtë të tjerët.

Tradisionalja ishte e ndërthurur mrekullisht me perceptimin real të jetës, dhe mes gjithë kësaj, do të jetë përherë tejet i nderuar, një kult i heshtur, figura e nënës, e reja dhe e bijave. (Vijon)



e gjithë vatrat, kur ata e kanë vënë në mesin e tyre. Nëpër duar ndjen shtrëngimin e duarve të tyre, në ballë ndjen puthjen e tyre, ua dëgjon fjalët dhe përsëri ndjehet mirë. Nganjëherë zemrën ia shtrëngon meraku i nanës, kraharori sikur nuk e mban mallin, por gjithçka është në rrugën e duhur dhe asaj i duhet të mbaje brenda vetes edhe merakun, edhe mallin, edhe trazimin që ia përkund era e natës.

Në jetën e saj ka parë mjaft, e ka filluar jetën duke ndjerë një peshë të madhe mbi të gjithë. Ka parë halle të mëdha e halle të vogla, halle që të plakin dhe halle që e kanë mërzinë deri sa të bjerë muzgu i parë i natës, por asnjëherë, edhe kur kanë qenë halle të mëdha sa bota, kurrë nuk ka përkultur kurrizin dhe tē fshajë mërzitshëm.

E di mirëfilli jetën e kësaj familje që para se tē vinte nuse. E dinte se filli i saj kishte qenë disa herë rezik të këpuntej, dhe është e lumtur kur i fal tetë fëmijë, tre djem e pesë vajza. Ndihet e qetë, sepse më shumë se kurrë, e ardhmja e Familjes është e sigurt.

I sheh punët e djemve tē saj, ata e kanë nisur herët rrugën për tē bërë diçka tē mbarë, nuk u

Kosovë, negociata të shpejtuara, por jo të nxituara



Prof. Lisen BASHKURTI

Në bisedime, dialog dhe negociata shpejtësia lidhet me faktorin kohë, i cili është tejet i rëndësishëm. Lidhur me shpejtësinë e arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi vërehen, gjithashtu, qasje diverse në të gjitha nivelet, lokale, rajonale dhe euroatlantike. Debat i dukje ka të bëjë midis 'shpejtimit' dhe 'nxitimit'. Por, në fakt, brenda këtij debati, në dukje për shpejtësinë, thelbë qëndron në shfrytëzimin e konjunkturave politike tek aktorë dhe faktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe te takтикat e caktuara diplomatike në shërbim të këtyre konjunkturave.

Një qasje është për shpejtimin e bisedimeve me qëllim që të afrohet zgjidhja përfundimtare e marrëveshjes gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi. Sipas këtij opzioni, ky shpejtum do ta ndihmonte stabilitetin në Ballkan, do t'i nxiste reformat e rendshme të të dy shteteve, do ta përshpejtonte rrugën e integrimit të Serbisë në BE dhe të Kosovës në NATO dhe BE. Kjo është qasja që dominon politikën dhe diplomacinë evropiane në këtë kohë, qasje e cila duket se ka kthyer sytë kah Ballkani Perëndimor me projekte rajonale të zhvillimit dhe me politikat evropiane të zgjerimit. I ngarkuari i BE-së për ndërmjetësimin Kosovë - Serbi, Lajçak, duket se mbështet shpejtimin, por jo nxitim e negociatave për përfundimin e marrëveshjes.

Qasja tjetër alternative për shpejtësinë e bisedimeve Kosovë - Serbi është për nxitim e tyre sa të jetë e mundur, me qëllim që marrëveshja përfundimtare gjithëpërfshirëse midis dy shteteve të finalizohet mundësish brenda shtatorit të këtij viti. Kjo qasje duket se ka zënë vend në një masë të

caktuar, jo krejtësisht të qartë në Shtëpinë e Bardhë. Nga media prestigjioze, analistë, diplomatë dhe personalitete amerikane, evropiane dhe ballkanike mendohet se ky nxitim i diplomacisë së Shtëpisë së Bardhë është më së shumti politikisht i motivuar nga zgjedhjet presidenciale në nëntor 2020 dhe i diplomatëve në shërbim të tyre.

I ngarkuari i presidentit Trump për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell duket se është mbështetës i nxitimit të negotiatave dhe arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi brenda pak muajsh. Përkujdesja e Grenellit është më shumë që t'i bëjë shefit të tij, siç thuhet gjérësisht në mediat botërore, një 'dhuratë suksesi' në politikën e jashtme në prag të zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2020 sesa vetë përmbajtja e marrëveshjes. Grenell është gati të pranojë çdo lloj kompromisi, qoftë edhe me kosto për Kosovën dhe në favor të njëanshëm për Serbinë, mjaftron që të jetë një kompromis i dakordësuar nga palët dhe pastaj ceremonia protokollare e firmosjes të bëhet në Shtëpinë e Bardhë përpëra presidencialeve të nëntorit 2020. Është e kuptueshme se mbas sfidave të diplomacisë Trump në Korenë e Veriut, në Iran, në Venezuelë, në Siri, në Kinë, në Palestinë e gjetë, një ceremoni suksesi për zëmrën e Evropës, Ballkanin, Kosovën dhe Serbinë do të ishte shumë e mirëpritur në Shtëpinë e Bardhë në prag të zgjedhjeve presidenciale.

Faktori politik në Kosovë, ndonëse në mënyrë jo fort të hapur, por më shumë me qëndrimet e veprimet e veta dhe më pak me retorikë politike është e ndarë në dy qasjet e shpejtësive alternative të lartpërmendura. Një pjesë është për shpejtimin e bisedimeve Kosovë - Serbi, por jo për nxitim e tyre. Pra, kjo alternativë është për... 'Running, but not rushing!' Pjesa tjetër, duket më e paktë dhe nga lart-poshtë në Kosovë është për nxitim ekstrem të bisedimeve me Serbinë, deri në fund të shtatorit të këtij viti,

mundësish ta arrijë edhe marrëveshjen brenda pak muajve.

Midis palëve alternative në Kosovë, presidenti Thaçi mbështetë, deri në deklarimin e fundit para mediave në fillim të qershorit 2020, bisedime të nxituara, që ta sjellin marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi 'brenda fundit të këtij viti'. Për të arritur këtë nxitim të paarsyeshëm, të padobishëm, të padrejtë dhe me shumë rreziqe, presidenti Thaçi, me apo pa dashje po i kontribuon përcarjes së unititetit euroatlantik, BE - ShBA për ndërmjetësimin ndërkombëtar Kosovë - Serbi. Duket se Thaçi është duke insistuar në ndërmjetësimin e njëanshëm të ShBA-së, personalisht të z. Richard Grenellit si dhe është duke kundërshtuar përfshirjen e BE-së, personalisht z. Miroslav Lajçak.

Lojërat midis dyshes ndërmjetësuese euroatlantike BE-ShBA, me qëndrimet anti-BE dhe gjoja pro-ShBA të presidentit Thaçi si dhe përpjekjet e tij për ta mbështetur opsonin e nxitimit deri në theqafje të bisedimeve dhe përfundimit të marrëveshjes përpëra nëntorit të këtij viti, janë jashtë çdo kuadri kushtetues si dhe jashtë çdo procesi gjithëpërfshirës parlamentar, politik dhe publik. Këta hapa personalë, presidenti Thaçi duket qartësisht se i ndërmerr përsye politike si dhe për probleme personale me drejtësinë. Thaçi, dyshoj se është gati të bëjë kompromise të dhimbshme tejet të rezikshme me territoret dhe ekonominë e Kosovës.

Aktorët dhe faktorët kryesorë në Kosovë kanë përvjohë me negociata ndërkombëtare në Rambuje në vitin 1999, në Vjenë me Ahtisarin 2005-2007, me Brukselin 2012-2018 dhe duhet ta dinë mirë se marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi është nga më të vështirat sepse tanimë ajo do të jetë një kompromis i madh jo vetëm dy palësh Kosovë - Serbi, por katërpalësh Kosovë - Serbi - BE - ShBA. Si e tillë kjo marrëveshje e kompromisit të

madh do shumë kohë e maturitet dhe kurrsesi nuk mund të nxitohet brenda pak muajve apo brenda këtij viti.

Natyrisht në shpejtësinë e arritjes së marrëveshjes kanë rolin e vet edhe dy negociatorët ndërkombëtarë, Grenell dhe Lajçak, profili i të cilëve do ta ketë ndikimin e vet. Grenell hyri në Kosovë me pozita të trefishta të larta, si ambasador në Gjermani, si drejtë i Shtatëmbëdhjetë Agjencive Inteligjente në ShBA dhe si mediator në bisedimet me Serbinë. Por shumë shpejt Grenelli u lirua nga posti ambasadorial në Berlin, nga drejtimi i Shërbimeve Inteligjente të ShBA-së e madje edhe nga Departamenti i Shtetit. Pozita e Grenellit tanimë është reduktuar në një mediator. Si mediator Grenelli deri tani paraqitet i paqartë. Grenelli është mediator, por jo aq me sjellje, qëndrime dhe veprime prej diplomati. Mediatori diplomatikisht është

ndërmjetësues dhe jo imponues. Mediatori politikisht është përafrues dhe polarizues. Suksesi i Grenellit do të varet shumë nga aftësia për të përafruar politikat në Kosovë e Serbi në mënyrë që të janë gjithëpërfshirëse dhe për të ndërmjetësuar diplomacitë e dy vendve në mënyrë që të arrihet kompromisi.

Miroslav Lajçak është politikan dhe diplomat nga Sllovakia, vendi i të cilit nuk e ka njohur Kosovën. Por, si ndërmjetësues, Lajçak është në rolin e përfaqësuesit të BE. Bazuar në Traktatin e Bashkimit Evropian, Lajçak nuk përfaqëson në qëndrimin e tij politikën

nacionale të Sllovakisë, as diplomacinë Sllovake. Çdo zyrtar i lartë i BE, nga momenti i ushtrimit të pozicionit në emër të Organizatës 'zhvesh' kostumin nacional dhe lë pas flamurin kombëtar, sepse vesh 'kostumin' e Organizatës dhe mban flamurin e saj. Suksesi i Lajçak si mediator në negociatat Kosovë-Serbi do të varet nga sa do të dijë të ndajë qartësisht dhe në mënyrë konsistente qëndrimin e shtetit nga i cili vjen, Sllovakisë prej qëndrimit të Organizatës që përfaqëson, BE. Ndërkohë, pavarësisht prej

profileve individuale, të dy ndërmjetësuesit, Grenelli dhe Lajçaku, kanë një mision të përbashkët që mund të realizohet nëpërmjet adresimit të dy sfidave. Së pari, ato të dy nevojitet që të arrijnë paraprakisht kompromisin midis dallimeve të tyre, respektivisht të BE dhe ShBA, ndaj qasjes për projektit që do do negociohet, për strategjinë e negocimit, për qëllimin dhe objektivat madhore, për prioritetet që do përcaktojnë për shpejtësinë e realizimit të marrëveshjes. Së dyti, pas rrafshimit të diferençave dhe arritjes së kompromisit midis tyre ato do të duhet ti bëjnë palët, Kosovën dhe Serbinë, që të rrafshojnë diferençat dhe të arrijnë marrëveshjen e kompromisit. Kjo marrëveshje e pritshme, tanimë nuk do jetë thjeshtë një kompromis dypalësh Kosovë-Serbi, por një kompromis i madh ndërmjet katër palëve në negociata, BE-ShBA-Kosovë-Serbi.

Bazuar në këtë analizë lidhur me shpejtësinë e negociatave dhe arritjes së marrëveshjes përfundimtare të dalë prej tyre, është e rekomandueshme për palët alternative në Kosovë, që të fokusohen më shumë për thelbin e marrëveshjes Kosovë-Serbi, që të jetë në dobi të pavarësisë, sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Kosovës. Ndërkohë, shpejtësia e procesit negociator për arritjen e marrëveshjes, duhet t'i lihet ecurisë së vetë procesit negociator të ndërmjetësuar nga uniteti Euro-Atlantik BE-ShBA dhe mediatorëve të emëruar prej tyre, Grenell-Lajçak.

Afat kohor, ose shpejtësia e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse përfundimtare lypet të mos ndikohet kurrsesi nga konjunkturat politike të qendrave ndërkombëtare dhe as nga agjendat politike apo diplomatike personale të askuji në Kosovë, në BE dhe apo në ShBA. Kosova ka lindur si projekt Euro-Atlantik, është projekt sui generis, i vështirë dhe lypet të përfundojë si i tillë deri në fund, me durim, qartësi, maturi dhe vizion. Prandaj kërkohet të shpejtohet, po jo të nxitohet.



Një front i bashkuar është gjëja e vetme që e shpëton Shqipërinë nga sundimi i huaj

Para fillimit të Konferencës së Paqes në Paris (1918), dy kampionët e pavarësisë së Shqipërisë, Aubrey Herbert dhe Edith Durham, mundohen t'i pajtojnë shqiptarët e përçarë dhe të formojnë një delegacion për konferencë. Personalitetet shqiptare kanë probleme të mëdha. Nuk flasin mes veti, e akuzojnë njëri-tjetrin për tradhti dhe nuk janë të vetëdijshëm për situatën e rëndë, në të cilën gjendet vendi i tyre. Në këtë letër, të cilën Durham ia dërgon Herbertit, njeriut i cili qëndronte pas organizimit të delegacionit, shihen disa probleme serioze që ka prodhuar naiviteti i personaliteteve shqiptare. Nga kjo letër shihet që as sot nuk është më mirë se atëherë.

**Nga: Edith DURHAM
(letër Aubrey Herbertit,
më 1918)**
**Përktheu dhe përgatiti:
Daut DAUTI**

I dashur kolonel Herbert, është shumë vështirë të dihet se si të mbushen mend këta njerëz. Unë mendoj se sa më pak që i shkruani I. K.-së [Ismail Qemalit] është më mirë pasi që nuk dihet se si do t'i shrem-bërojnë dhe keq-citojnë thëniet tua. Nëse I. K-në e takon në Paris dhe bisedon për këto çështje me të, do të jetë shumë më mirë. Ajo që dëshirojmë të kuptojmë, mendoj se është kjo: Pse është

paraqitur kjo përçarje? Në lidhje me çka është ajo? Aq sa kam mundur të mësoj nga Dakot (me të cilët ka nisur përçarja) ka të bëjë vetëm meakuza të rre-jshme që janë bërë kundër Mehmetit [Konicës]. Natyrish, në mënyrë strikte, kjo duhet të mbetet vetëm mes nesh. Zonja D. [Dako] më ka shkruar (në përgjigje të kërkesës sime të fuqishme se nuk duhet të përçahan) – se ata i dinin të gjitha për Mehmetin dhe e dinin se ai ishte i përfshirë në një komplot për t'ia shitur Greqisë jugun e Shqipërisë. Ajo, po ashtu, më ka thënë se biseda me z. Woods ia ka konfirmuar dyshimet për pa aftësinë e Mehmetit. E di që Woods është shumë i shqetë-

suar me M. për atë që ka thënë se është shumë e mundshme se asnjëra palë të mos e fitoj luftën dhe se do të përfundoj me rezultat të barabartë e që do t'i lodhë të dy palët. Ai [Woods], po ashtu, ishte tejet i shqetësuar për zonjën Aubrey të cilën e konsideron anti-angleze. Padyshim ajo ishte influencë e keqe. Ajo që më frikëson është se ai ka folur shumë për Dakot. Ju ndoshta e dini që Vatra i ka bërë atij një pritje madhështore, në të cilën, Dakot dhe partia e tyre refuzuan të merrnin pjesë. Tashti, aq sa mund të marrë vesh nga gazetat, Dakot e shpallin atë si kampion të kauzës së tyre.

Besoj që ai ndjenë se e ka tollovitur këtë gjë pasi që ka thënë se do të më shkruaj dhe do të më njoftoj për gjendjen, por nuk kam marrë asnjë rresht prej tij. Kam frikë se ai e ka

mbjellur idenë se për shkak të zonjës A: Mehmeti është anti aleat dhe se me këtë i ka infektuar Dakot.

Nëse mund të marrësh vesh nga Ismaili, se cila është baza e kësaj rrëmuje, do të ishim në gjendje të bënин diçka. Dëshira ime është që ta dërgojmë Dakon delegat. Ai është mjafueshëm i arsimuar që të jetë i dobishëm dhe nëse del nga rethi i tij i vogël, me siguri do të jetë në gjendje që ta pranoj se sa rol mikroskopik luan Shqipëria këtu në mendjet e njerëzve dhe, se si, çdo përçarje ua shkatërron gjasat. Ai i sheh gjërat nga një perspektivë mjaft e rrejshme. Në lidhje me letrën tuaj, më duhet ta përfundoj në vijën që e kam caktuar dhe fjalinë e fundit ta bëjë edhe më të fuqishme: "Një front i bashkuar është gjëja e vetme që mund ta shpëtoj vendin tuaj nga sundimi i huaj"

apo diçka tjeter me këtë efekt. Të vetmen gjë që mund ta bëjmë, është që të provojmë t'i frikësожmë në mënyrë që të bashkohen. Dhe, ata me të madhe i mbiçmognë kapacitetet e tyre ushtarake. Ende besojnë në "banda" dhe në metoda mesjetare. Derisa sot një armatë e vogël do t'i shtypte shumicën e tyre, tërë municionin dhe furnizimin me ushqim dhe do t'i zhdukte kurdo me disa mitralozë dhe do të dorëzoheshin para se të vdisnin nga uria. "Shpalljet" e Lichnowskyit na kanë shkaktuar dëme të pallgaritshme. Kudo që i kemi lexuar njerëzit e rinj, janë të bindur se formimi i Shqipërisë është komplot gjerman dhe që e ka shkaktuar luftën. Mavrogordata ka shkruar një artikull në të cilin thekson se, sikur shqiptarët të mos nxiteshin nga Austria, kurrë nuk do ta kishin dëshiruar pavarësinë dhe se do të "asimiloheshin" lehtë nga Greqia.

Dhe, kohëve të fundit, disa njerëz më kanë lutur që të mos humbë më tej kohë për ta [shqiptarët] pasi që secili pajtohet me Lichnowskyin.

Nëse mundesh, kërko nga Ismaili që ta marrësh vesh se në lidhje me çka është tërë kjo përlamje. Dhe, mundohu ta bindësh se akuzat kundër M, nëse ai i përsëritë siç i përmenda, janë broçkulla./Telegrafi

*Sinqerisht e juaja,
Edith Durham.*



E rrallë

Djali që ka 2 371 celularë

Jayesh Kale është një koleksionist në Indi i cili ka kaluar të paktën pesë vjet duke mbledhur telefona celularë, duke i quajtur pajisjet si "foshnjat" e tij. "Unë jam shumë emocional. Unë nuk mund ta shoh dikë duke i hedhur telefonat e mi. Nuk mund ta shoh dikë duke i thyer ata. Ata janë fëmijët e mi", tha Kale për "CNN". Kale është një koleksionues nga Thane



në Indi dhe deri më sot ai ka mbledhur gjithsej 2 371 telefona celularë.

FOTO E DITES



Fëmijët shihen duke shkarkuar një kamion në tregun me shumicë të perimeve Okhla në New Delhi / AFP/

E jashtëzakonshme

Pema që mbalon dy hektarë tokë dhe duket si një pyll i vogël në Brazil

Një pemë në Brazil është rritur aq shumë saqë po mbalon dy hektarë tokë, me një sipërfaqe prej 8,500 metrave katrore. Sipas mediave të huaja, hapësira e mbuluar përreth i ngjanë një pylli të vogël dhe është e njohur në librin e "Guiness" si pema më e madhe shqeme në botë dhe po rritet ende.



DASHI
Shfrytëzoni sa më mirë imagjinatën, komunikimin, simpatinë dhe inteligjencën tuaj strategjike.



DEMI
Një keqkuptim i vogël do t'ju detyrojë të ndaloni së vepruar, gjithashtu mund të shërbejë edhe si një mekanizëm mbrojtës.



BINJAKËT
Ju pret një e hënë e mirë. Ju jeni të rrethuar nga njerëz miqësorë dhe do të keni shumë energji e entuziazëm.



GAFORRJA
Do të keni një gjendje shpirtërore të ulët për shkak të situatave që po përballen. Në punë ju do të punoni shumë, por do të merrni pak.



LUANI
Në fund të orarit tuaj të punës, mos u bëni dembel dhe shfrytëzoni kohën e lirë për të bërë aktivitet fizike. Jeni luan dhe dembelizmi nuk është tipar i juaji.



VIRGJERESA
Është koha për iniciativa të reja. Me aftësitë tuaja ju do të korrni një sukses të madh dhe do të krijoni zgjidhje të reja.



PESHORJA
Bëuni të fortë dhe shtyni gjérat që dëshironi të bëni deri të enjten. Akumulimi i angazhimeve vetëm sa do t'i përkëqësojë gjérat.



AKREPI
Tërheqëse, takime të rastësishme dhe lajme të mira. Një marrëveshje biznesi do të shkojë më mirë sesa pritej.



SHIGJETARI
Përfiton nga mundësitet e ofruara. Kanalizoni energjitet tuaja në një mënyrë pozitive.



BRICJAPI
Ngadalëson çdo iniciativë. Jini mosbesues ndaj gjërate, mos bini pre e asnje provokimi.



UJORI
Do të keni pakënaqësi në frontin sentimental. Do të jeni të etur të ndiheni të dashuruar dhe të admiruar nga partneri juaj.



PESHQIT
Ka lajme të bukurë në horizont, por jini të durueshëm derisa të vijnë. Nëse flasim për dashuri, ju do të keni shumë dyshime, por mos i shfaqni hapur që në fillim.

BARSOLETA E DITËS



Anija ndalon në një port dhe të gjithë marinaret vërshojnë në tokë, me përjashtim të njërit. Kapiteni e pyet:

- Po ti, s'ke një grua në këtë port?
- Kam, si s'kam, por është gruaja ime.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Çifti befason ndjekësit, blen vilë super luksoze vetëm me paratë nga Instagram

Instagram është rrjeti social më i përdorur dëshira e këtë arsyë nëse përdoret si burim të ardhurash ka gjasë që paguan më mirë se kushdo tjetër.

Të paktën këtë kanë nxjerrë mësim çifti

Jack Morris, 29 vjeç, dëshira e dashura e tij Lauren Bullen, 27 vjeçë.


Dy të rinjtë janë blogerë në Instagram dhe vetëm Lauren ka thaujse 5 milionë ndjekës në llogarinë saj, çka e gjithë kjo 'famë' virtuale u është përkthyer në fitime marramendëse.

Në një bisedë me ndjekësit e tyre, çifti zbuloi pamjet e vilës luksoze të cilën e kishin blerë dëshira e fitimet e nxjerit



ra nga rrjetet sociale.

Jack nga Britania e Madhe dhe Lauren nga Australia, treguan se deri tani kishin shpenzuar në vilën e tyre plot 1.2 milionë euro. 29-vjeçari u shpreh: "Ne nuk kemi prindëri të pasur. Vijnë nga familje me të ardhura mujore normale. Ne kemi fituar para vetëm përmes rrjeteve sociale. Ne bashkuam të ardhurat tona dëshira e fitimet e nxjerit



LUANI
Në fund të orarit tuaj të punës, mos u bëni dembel dhe shfrytëzoni kohën e lirë për të bërë aktivitet fizike. Jeni luan dhe dembelizmi nuk është tipar i juaji.



VIRGJERESA
Është koha për iniciativa të reja. Me aftësitë tuaja ju do të korrni një sukses të madh dhe do të krijoni zgjidhje të reja.

Stresi s'pyet për Covid, festë të çmendur për 33-vjetorin



Reperti i njohur Stresi ka mbushur 33 vjet, ndërsa ka festuar dje me miqtë e tij, në një festë ku nuk munguan fishekz-jarrët e shampanja. Në një video të postuar në "Instagram", Stresi duket teksta shijon atmosferën, ndërsa

rritja e numrit të të infektuarve me koronavirus duket se nuk i bëjnë shumë përshtypje reperit, ndërsa në festë shihet qartë mungesa e distancimit social. "Vetëm Zoti e di sa jam i gjëzuar", ka shkruar Stresi krahës videos.

Butrinti "biond", paralajmëron diçka të nxehjtë



Këngëtari Butrint Imeri ka ndërruar stilin, duke u paraqitur më ndryshe përfansat. Butrint Imeri është duke u përgatitur përfson e verës dhe tanimë e ka gati projektin e

radhës që do ta lansojë së shpejti. Ai këtë e ka bërë me anë të një video që e ka postuar në "Instagram", me të cilën paralajmëron këngën e saj e cila quhet "Si përpara".




Kim Kardashian zbavit fansat me foto provokuese

Ajo është një nga femrat më të komentuara në mediat rozë dhe në rrjetet sociale. Kim Kardashian shquhet përfomat bombastike të cilat nuk heziton t'i nxjerrë në pah në rrjetet sociale, madje të rralla

janë rastet kur ajo nuk provon me fotografitë që publikon. Së fundmi ylli televiziv ka provuar fansat me një fotografi, ku shfaqet me një kostum rozë, që i nxjerr në pah gjoksin shpërthyesh dhe format bombastike.

Kur Monica Bellucci n uk i rezistonte dot Leonardo DiCaprios



Monica Bellucci njihet si ikona e bukurisë femërore. Ajo është një prej grave më të bukura në botë, "titull" që vazhdon ta mbajë edhe sot, pavarësisht viteve që ka mbi supe. Mediat

së fundmi kanë publikuar foto të saj me aktorin simpatik Leonardo DiCaprio. Fotografia është e vitit 1995, atëherë kur djaloshi ishte në fillimet e tij, ndërsa Monica në kulmin e shkëlqimit.



Ismail Kadare: Leximi i Hamletit

1.

Kisha pesë vjet që shkoja në shkollë dhe, natyrish, qdo stinë mësoja gjëra të reja. Një pjesë e tyre ishin vërtet të reja, por disa nuk ishin veç të dëgjuara edhe më parë, por të kuptuara gabim, kështu që, gjithsesi, tingëllonin ndryshe. Kështu, për shembull, atë pranverë mësuam që vendi ynë ishte republikë. Po atë ditë, mësuesi na shpjegoi se para disa vitesh Shqipëria paskësh qenë mbretëri. Sipas mësuesit, në atë kohë ne ishim katër ose pesë vjeç. Kështu që diçka duhej të mbanim mend. Në të vërtetë, nuk na kujtohej ndonjë gjë e madhe, ndonëse kishim turp ta pranonim. Ishim të bindur se nuk ishte e lehtë të gjeje ndryshimin midis mbretërisë dhe republikës, aq më tepër që prindërit tanë, qoftë në mbretëri, qoftë në republikë, ishin po ata, madje të tillë ishin edhe kushërinjtë. Dikush u kujtua të thotë se edhe shtëpitë ishin po ato.

Biseda për shtëpitë e ndërlidhësi pas gjithçka. Sipas atyre që dëgjonim nga të mëdhenjtë, jo vetëm që shtëpitë ishin të gjitha të kohës së vjetër, por, për të saktësuar gjërat, duhej thënë se shumica e tyre ishin më të moçme se vetë mbretëria. Shkurt, ato ishin të një kohe tjeter, asaj të perandorisë.

Ishte hera e parë atë pranverë që mësuam se Shqipëria, përparrë se të ishte mbretëri, paskësh qenë

perandori ose, më saktë, pjesë e një perandorie. Diku e kishim dëgjuar këtë fjalë, por vetëm tani mësuam që një perandori ishte dhjetë apo njëzet herë më e madhe se mbretëria dhe kryeqyteti i saj, bashkë me perandorin, domethënë sulltanin, ndodheshin gjithmonë tepër larg.

Dihej se zbulimet tërhiqin shpesh njëri-tjetrin, kështu që ne, këtë herë me mendjen tonë dhe pa ndihmën e mësuesit, i dhamë shpjegim diçkaje që më parë nuk e kishim vënë re: shtëpitë e hershme, domethënë ato të perandorisë, ishin shumë herë më të mëdha se ato të mëvonshmet, në atë masë që perandoria kishte qenë më e madhe se mbretëria. Sa për republikën, qysh se ajo ishte vendosur ende nuk ishte ndërtuar asnjë shtëpi, kështu që trajta e tyre s'dihej.

Gjëja e parë për të cilën u nguta të sigurohem, ishte që shtëpia e prindërvë të mi ishte e kohës perandorake. Një gjë e tillë bënte mu që larg. Si të mos isha rritur në të, por të kisha bujtur befas, po vija re me habi madhësinë e dhomave, hajatet e zbrazëta, mesoret e panevojshme dhe musandrat pa kuptim.

Në shkollë, në orën e mërzitshmë të gjemëtrisë m'u kujtua një tjetër mufkë e shtëpisë sonë: ajo s'e kishte për gjë që gjatë çdo meremetimi të pillte dhoma ose të gjalltiste pa të keq një apo dy të tillë. Kjo ishte, me sa dukej,

arsyeja që askush s'i donte meremetimet, me përashtim të babait. Në të vërtetë, në prag të tyre, edhe ai dukej sikur s'i donte, ngrysej ditë me radhë, nuk fliste me askënd, gjersa vendimi më në fund merrej, meremetimi fillonte dhe bashkë me të, si të çlrohej nga një ngërç, tim eti i kthehej e folura e natyrshme.

Në klasën tonë, gjysma e nxënësve i kishin shtëpitë të tilla, perandorake, por, për çudi, kjo nuk na shkaktonte ndonjë ndjesi krenarie. Kjo vinte, me sa dukej, ngaqë, ndonëse nuk e thoshim haptas, ato nuk na pëlqenin. Kjo ishte edhe arsyja që, kur shokët e klasës, ata me shtëpi mbretërore, qëllonin të vinin te ne, ne qëndronim të heshtur përparrë habitës së tyre.

Në të vërtetë, punët kishin shkuar edhe më larg. Jo vetëm që s'na pëlqenin shtëpitë tonë, por fshehtazi i kishim smirë shtëpitë e shokëve, ato mbretëroret. Ishin vërtet të vogla e pa porta madhështore, por brenda, duke qenë më të mbledhura, ngjanin më të ngrohta dhe, kryesorja, nuk kishin gjëra që s'pranonin shpjegim. Veç kësaj, kisha bindjen se në këto shtëpi fliteshin fjalë më të shpeshta dhe, kryesorja, më të embla.

Në shtëpinë tonë, për shembull, fjalët ishin të rralla. Dhe s'kishte si të ndodhë ndryshe në një shtëpi me tri kate të hallakatura, ku për të gjetur nënë ose motrën (për babanë as që bëhej fjalë), duhej të shpenzoje gjithë atë kohë.

Gjatë kërkimit, qëllonte që e harroje atë që do të thoshe, çka të bënte nervoz, aq sa kur tjetra, kur e gjeje, më në fund, në vend të një fjalë të butë, të thoshte: c'i ke ato buzë të varura!

Isha i bindur se në shtëpitë e moçme njerëzit jo vetëm që ishin më të zymtë, por edhe më krenarë. Ajo që s'kuptohej mirë ishte se cila prej të dyjave ngucute tjetren. Nganjëherë më dukej se ishin të zymtë, ngaqë njerëzit krenarë s'mund të mos ishin veçse të tillë e, nganjëherë, e kundërt, që ishte pikërisht zymtia ajo që i bënte krenarë.

Shtëpia e madhe kishte edhe huqe të tjera. Kështu, për shembull, ndërsa në banesat mbretërore njerëzit i kalonin të katër stinët e vitit në të njëjtat dhoma, në shtëpinë tonë ne zhvendoseshim çdo stinë nga njëri kat në tjetrin. Kështu që, me ardhjen e vjeshtës ose të dimrit, përparrë se të ndryshonte qielli me retë dhe me bubullimat, për ne ndryshonin muret, qiellzanat dhe musandrat pa kuptim.

Ndërkaq, mund të thuhej se kjo nuk ishte ndonjë gjë kushedi çfarë, në krahasim me një të keqe tjetër. Në shtëpitë e mëdha, netët ishin shumë më të frikshme se në banesat mbretërore. Kjo vinte, me sa dukej, nga dhomat dhe hajatet e zbrazëta. Ngaqë ishin pa njerëz të familjes, ishte e natyrshme që ato të kërkonin të mbusheshin me diçka. Kjo diçka tjetër nuk mund të ishin veçse njerëz të huaj ose zëvendës të

njerëzve, hijet. Me fjalë të tjera, kusarët dhe fantazmat.

Atë stinë të paharrueshme, të dyja palët ishin të pranishme kudo. Për sa u përket të parëve, kusarëve, mësuam se mbretëria i kishte bërë zap dikur, por republika, ngaqë ishte ende e re, s'ua kishte gjetur dot anën. Kurse hijet, ndonëse radioja fliste ditë e natë kundër tyre, duke i quajtur madje si pjellë e fashizmit, e Amerikës dhe e Izraelit, nuk jepnin ndonjë shenjë zmbropsjeje.

Natën, kur s'më zinte gjumi dhe dëgjoja trarët e pullazit të kërcisin, nuk e gjeja dot cilën nga dy të këqijat do të zgjidhja: kusarët apo fantazmat. Herë më dukej më e frikshme njëra palë e herë tjetra. Sidoqoftë, isha i bindur se ato nuk mund të vinin kurrë bashkë, madje, në njëfarë mënyre, ishin në armiqësi me njëra-tjetren. Kaq shumë më ishte mbushur mendja për këtë, saqë kur ndonjë natë, nga kërcitjet e trarëve dyshoja se kusarët po kacavirreshin nëpër to, éndërrroja që në atë çast t'ia behnin fantazmat, i sigurt se do të bëheshin aleate me mua kundër kusarëve. Por kishte netë të tjera kur prania e fantazmave ngjante kaq e lemerishme, saqë mbërritjen e kusarëve dhe përlleshjen e tyre me to e quaja shpëtimtare.

2

Në dalje të pranverës, ky farë drejtpeshimi u prish papritur.

Shteti, domethënë republika, u dha një goditje të befasishme kusarëve. Jo vetëm e kapi shumicën, por vargun e tyre, të lidhur me pranga, e shëtitë mespërmes qytetit. Ndonëse fytyrat i kishin të nxira, sipas zakoneve kusaro, njerëzit i njohën megjithatë. Ata mbetën gojëhapur kur, midis kusarëve, panë të ecte kokulur mësuesin tonë të urtë të historisë, atë që na kishte folur së pari për ndryshimin e mbretërisë nga perandoria e të tjera gjëra si këto. Habi edhe më të madhe kishin shkaktuar dy zotërinj të tjerë, njëri prej të cilëve, përveç që ishte avokat, vuante nga reumatizma, çka nuk ishte lehtë të përfytyrohej duke u kacavjerrë nëpër trarët e pullazeve.

Me gjithë dyshimet lidhur me kusarët e kapur, për një çudi të madhe, pas kësaj varavinge nëpër qytet, kusarët, të rremët bashkë me të vërtetët, u zhdukën përnjëmend.

Ishte diçka që i gjëzoi, pa dyshim, të gjithë, përveç meje. Kisha mbetur i vetëm e pa aleatë përballë hijeve. Rënien e natës e prisja përherë e më me shqetësim dhe trarët e shtëpisë kërcisin përherë e më kërcënueshëm. Duke marrë zemër nga mundja e shemrëve, fantazmat ishin, me sa dukej, në festë. Me afrimin e mbrëmjes, mendimet për kusarët sa vente më zbuteshin, kurse aty nga mesnata, kur ora e keqe afronte, ato shndërrroheshin në një mallëngjim të vërtetë.

Një ditë dëgjova se ishin bërë arrestime të reja, midis të cilëve, mësuesi i latinishtes, në gjimnazin ku shkonin dy ungjërit e mi. Një shpresë e turbullt se kusarët ende nuk ishin zhdukur dhe përderisa ishte kështu një ditë mund të ktheheshin, më mbushi gjithë gjëzin. Vrapova te shtëpia e ungjërvë për të marrë vesh diçka, por ajo që dëgjova më zhgënjeu. Mësuesi i latinishtes, bashkë me të arrestuarit e tjerë, s'kishte qenë aspak kusar, siç kisha shpresuar unë, por "agjeti i anglo-amerikanëve".

Kjo shprehje e re përdorej gjithmonë e më shpesh kohët e fundit. Që agjetët anglo-amerikanë ishin kundër republikës, këtë e dinte edhe bufi, por unë, më shumë se për këtë, isha kureshtar të dija se si i kishin punët me fantazmat.

Në të vërtetë, kisha një pezm të turbullt kundër vetë republikës, e cila, duke qenë aq e zellshme kundër kusarëve, tepër e ngathët po tregohej me fantazmat. Ato që thuheshin në radio kundër tyre, në një vesh të hynin, nga tjetri të dilnin. Kurse në shkollë, e njëjtë histori: ca fjalë sa për të larë gojën, mos besoni në brockullat të tillë, hije, shtriga e lugetë, të gjitha janë profka. Dhe tanë të kalojmë në gjëra të rëndësishme, siç është përbërja e ujit.

Unë mezi e mbajta veten të mos thërrisja: ore matuf, ore tutkun, si kujton se do na mbushësh mendjen se uji qenka më i rëndësishëm se fantazmat? Bashkimi i hidrogjenit me

oksigenin, pa shiko, na çudite. Punën e ujit e dinte dhe bufi: bie shi, kthehet në avull, prapë bëhet shi e kështu me radhë, gjë më e mëritshme as që mund të mendohej. Dhe ajo përbërja e tij, zbulim i madh, për besë, H₂O, lëre, lëre, ç'mister! Mister e shkuar misterit ishte përbërja e fantazmës dhe jo ajo e ujit.

Për fat, pezmi ndaj mësuesit nuk ishte gjer në atë shkallë sa të kalonte në zemërim kundër vetë ujit.

3

Një ditë, tek flisnim për fantazmat, një shok i klasës më tha se, sipas gjyshes së tij, mbrojtja më e mirë kundër tyre ishte shenja e kryqit. Vendosej nëpër cepat e shtëpisë, sidomos në ndërkalimet, nga ku hijet mund të hynin. Më pëlqeu shumë ky mendim dhe, pa i treguar kujt, nëpër shtëpi, bashkë me shokun tim, vendosëm në trarët e pullazit kryqe prej druri, që i sajuam bashkë.

E prita me padurim natën, por, për fat të keq, kërcitja e fantazmave u ndie njëlloj si më parë, në mos më fort.

Disa ditë më pas, shoku im, gjithashtu sipas këshillës së gjyshes, më solli temjan. Fantazmat prapë nuk u qetësan. Ndoshata kryqi dhe temjani mbronin vetëm të krishterët, tha shoku im. Unë e vështrova gjithë habi, ngaqë s'më kishte shkuar ndër mend që fetë i kishim të ndryshme.

Një ditë tjetër m'u kujtua ai shkrimitari me emër të vështirë Sha-ke-spe-a-re, libri i të cilit, për shkak të magjisticave dhe të fantazmave, më kishte pëlqyer aq fort, saqë kisha kopjuar gati gjysmën.

Të dy ungjërit mezi e mbajtën buzëqeshjen tallëse, kur panë që te rafit i bibliotekës së tyre po kërkova prapë diçka. Më në fund, e gjeta. Sha-ke-spe-a-re. Hamleti, princi i Danimarkës.

- Lexoje, lexoje, që të bëhet mendja dhallë, më keq se ç'të është bërë, - më tha ungji i vogël. As që më bëhej vonë për talljet e tyre. Ata kishin punët e tyre, unë të mbiat. Le të mburreshin me nofkën "rrahës profesorësh të latinishtes" a të studionin përbërjen e ujit. Unë kisha punë me fantazmat.

Gjeta një kënd të qetë dhe nisa të lexoj. Libri po më mahniste, sidomos pjesa ku hynte në skenë fantazma. E përpiva çdo fjalë të saj, madje erdhi një çast që mbeta gojëhapur. Ishte çasti kur fantazma i shpjegonte Hamletit se i duhej të ngutej, ngaqë po afrohej koha kur gjeli do të këndonte dhe ajo duhej të kthehej në varr.

E lexova disa herë për t'u bindur se e kisha kuptuar drejt. Ishte pikërisht ashtu: fantazma duhej të tretë sapo afronte mëngjesi, pra, kur gjeli këndonte. Ky paskësh qenë një urdhër për të gjitha fantazmat. Me fjalë të tjera, ato që nuk kishin frikë nga asgjë, as nga arma, as nga kryqi, as nga radioja, as nga im atë, madje as

nga republika, na u trembkëshin nga gjeli.

Ky zbulim më mahniti fare. E lashë librin dhe, duke rendur si i marrë, u nisa për në shtëpi. Isha i bindur se e kisha gjetur shkakun përsë në shtëpinë tonë vërtitesh fantazmat: mungesa e një gjeli.

Sapo kapërceva portën, e pyeta ose, më saktë, i ulërita gjyshes: përsë nuk kemi gjel!

Gjyshja m'u përgjigj ftohtë se s'kishim gjel, ngaqë s'mbanim pula.

Sytë e saj ngjyrë hiri m'u dukën tallës, ashtu si të ungjërve. Një pezmi i madh po më merrte frymën. M'u duk e padrejtë që sapo ndodhë diçka që kishte lidhje me Sha-ke-spe-a-re-n, ata të gjithë nisnin të talleshin. Kur e pa që po kafshoja gishtat nga zemërimi, gjyshja më foli me zë të butë:

- C'të hipi kështu për gjel?

- Ja që më hipit.

Sedra nuk më linte tia thosha arsyen. Ajo më përkëdheli flokët dhe me zë të ulët, si të rrëfente një përrallë, u përpoq të më shpjegonte se, pavarësisht se ishim nevojtare, ne nuk mbanim pula, sepse zakonet e shtëpive të vjetra kështu ishin dhe se, ndoshta, më vonë, kur zakonet të ndërronin...

Prej kohësh pothuajse e kisha kuptuar. Gjyshja ime, ashtu si shoqet e saj, ishin të gjitha buzëholla dhe ishin gati të vuanin nga uria, veç të ruanin saltanet, me fjalë të tjera, ta pinin kafenë me filxhanë të shtrenjtë dhe bisedat t'i bënë si zonjat e mëdha dhe sjelljet t'i kishin po ashtu. Me një fjalë, të mos mbanin pula!

- Po ty, po të ketë vajtur mendja për mish pule, t'i themi babait.

- Çfarë?

- Mos i shtrembëro sytë ashtu! Po të ketë vajtur mendja, sado

ngushtë të jetë yt atë, një pulë mund ta blejë.

- Ç'pulë? - klitha unë. - As që dua tia di për mish pule. Unë dua gjel, kupton apo jo? Gjel që këndon ndaj të gdhirë dhe dëbon fantazmat.

Gjyshja nuk m'i ndante sytë. Me siguri, më merrte për të çmendur. - Aha, - ia bëri pas pak. Iu kujtua, siç duket, që i kisha folur edhe një herë tjetër për fantazmat dhe prapë më ledhatoi flokët.

- Ku e di ti që kënga e gjel i zbon fantazmat? Në shkollë të kanë thënë?

- Jo. E kam lexuar. Sha-ke-spe-a-re e ka thënë.

- C'është ky?

- Shkrimitar. Më i madhi i të gjithëve.

- Aha, - ia bëri prapë gjyshja mendueshëm. - Po të jetë kështu, nuk ka nevojë të kemi gjel në oborr të shtëpisë. Ti mund të dëgjosh gjelin e kako Pinos. Ose atë të Torove. Ose të Xhaxhiaje matanë rrugës.

Tek fliste, mendoja se ishte prapë ajo puna e shtëpive të perandorisë e të mbretërisë, që ngatërronte çdo gjë. Me fjalë të tjera, shtëpitë perandorake, ndonëse të handakosura, ende nuk mbanin pula, që të mos u binte hunda, kurse mbretëroret e kishin ulur kryet ndërkajq. Sa për banesat e republikës, merrej me mend se jo vetëm pula, por edhe laraska e bretkosa, po të ishte nevoja, do të mbanin.

Biseda me gjyshen më qetësoi disi. Tani mezi ç'prisja rënien e mbrëmjes. Një trazim i pazakonshëm s'më linte të rrija në një vend. Gjyshja më hetonte me ca sy të shqetësuar, por mua aq më bënte. Tani kisha një aleat të ri, të cilit i besoja më shumë se tim eti, se gjithë mësuesve bashkë, madje më shumë se republikës.

Sha-ke-spe-a-re. Emrin e kishte të tillë që të sillte ndër mend shkreptimën. Dhe ishte nga i njëjtë vend i largët, që pak kohë

më parë dërgonte aeroplanë bombardues për të dëbuar fashistët. Kurse tani, si të kishte dëgjuar thirrjen time të fshehtë, kishte dërguar këtë shpëtues të ri.

4

Darka m'u duk më e mëritshme se herët e tjera. Dhe fjalët ishin të gjitha të përsëritura, bashkë me heshtjet midis tyre. Ato zgjateshin sidomos kur që jashtë dégjoheshin trokitje portash. Te Shtinot! thoshte nëna, duke ngritur kryet. Pastaj shtonte: te Kokalarët! Fjalët "prapë arrestim?", ndonëse nuk i thoshin, kuptohej që i mendon. S'kishin faj, ishin të pambrojtur, pa aleatë të fshehtë, ndaj dhe u jepnin më shumë rëndësi se ç'duhej gjërate të rëndomta.

Pas darke ramë të flinim njëri pas tjetrit. Pak kohë më pas trarët e pullazit nisën të kërcisin. Fantazmat, sikur ta dinin se diçka kishte ndodhur, ngjanin të shqetësuara. Nata ishte e errët. Nuk kuptohej kurrsesi ç'kohë ishte. Në shkollë kishim mësuar se mesnatë quhej ora dyshëdhjetë, por në asnje libër nuk thuhej se në ç'orë këndonin gjelat. Një herë më kapi frika: po sikur t'u dilte gjumi vonë, si përtacëve, ose të mos zgjoheshin fare?

Shi kur e kisha humbur shpresën, një frushullimë e njohur u ndie befas nga ana e dritareve të jugut e fill pas saj, përplasja ngadhënjese e krahëve dhe britma "ki-ki-riku!" e mbushi botën me një tërsëllimë, hare e mallëngjim të paparë. Gjeli i kako Pinos... Nuk arrita as t'i mendoja këto fjalë, kur nga krahë tjetër i shtëpisë, gjeli i Torove, me të njëjtin zell, në mos më të madh, e dha kushtimin. Më tej, ai i Shametëve e fill pas tij, ai i Ficove dhe ai i Dino Çiços e kishin lëshuar klithmën në kupë të qiellit.


Një shkrehje dhe një paqe hyjnore e kaploj krejt qenien time. Ata kushtimonin rrësht, njëri pas tjetrit nga oboret e Skëndulajve, të Hankonatëve, të Babametove, të Kokobobove, të Karogjozatëve, secili më zhurmëmadh e më i etur për kacafytje se tjetri. Le të dridhesin fantazmat,asnje mësirë s'kishte për to. Vetë Sha-ke-spe-a-re i tmerrshëm kishte urdhëruar.

Ndërsa gjumi po m'i mylltë sytë, përfytyroja se si gjelat vazhdonin të jepnin kushtimin, si nga maja katedralesh, më larg, në katundet e Lunxhërisë dhe më tej, në Shqipërinë Qendrore, që e dija nga mësimi i gjeografisë dhe përtej saj, në Nikaj-Mërtur dhe pastaj në Mal të Zi dhe edhe më larg, në Danimarkë dhe, pa dyshim, në tokën angleze, vendin e idhullit tim të ri.

Qiejt e pastruar shtilleshin, ndërkajq, të përtirirë, njëri pas tjetrit. Mendja ime po i avitej ndoshta Polit të Veriut, në kohën që gjumi, më i èmblit që kisha shijuar ndonjëherë, më kaploj krejt./Exlibris

Paris, qershori 2004





Bojku: Ta vazhdojmë këtë seri të suksesshme

Besmir Bojku ka thënë për "Epokën e re" se Feronikeli është i përgatitur që ta vazhdojë serinë e rezultateve pozitive deri në fund të kampionatit. "Kemi një seri të mirë të rezultateve dhe shpresojmë ta vazhdojmë këtë seri. Ne do t'i marrim ndeshjet një nga një dhe në secilën prej tyre të hyjmë me seriozitetin më të madh sikurse të ishin finale", ka thënë Bojku

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Mesfushori i Feronikelit, Besmir Bojku, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se skuadra kampione në fuqi e Superligës duhet ta vazhdojë formën e mirë që ka aktualisht deri në fund të kampionatit.

Pas rikthimit të futbollit, pas pauzës së gjatë për shkak të

pandemisë Covid-19, Feronikeli ka regjistruar dy fitore në kampionat ndaj Vushtrrisë (3-1) dhe Dukagjinit (0-2), kurse në gjysmëfinalen e parë të Kupës kundër Ballkanit në Suharekë luajti baras 0-0. "Kemi një seri të mirë të rezultateve dhe shpresojmë që të vazhdojmë këtë seri. Ne do t'i marrim ndeshjet një nga një dhe në secilën prej tyre të hymë me seriozitetin më të madh sikurse

të ishin finale", ka thënë Bojku. Ndeshen e radhës "Nikli" e zhvillon kundër Ballkanit. Lidhur me synimet në këtë ndeshje, Bojku është shprehur mjaftë i matur, duke thënë se skuadra që drejtohet nga Ismet Munishi është ndër më të mirat në vend.

"Për Ballkanin nuk duhet harxhuar shumë fjalë pasi e ka një ekip shumë të mirë dhe padyshim se janë ndër skuadrat më të mira në vend", ka deklaruar ai. Bojku, i cili ka treguar formë të mirë në këtë edicion, kontratë me kampionët



e Kosovës ka deri në fund të këtij kampionati. I pyetur për të ardhmen, mesfushori nuk ka dhënë shumë detaje, pasi aktualisht është i fokusuar në ndeshjet e mbeturat të kampionatit 2019/2020. "Kontrata më përfundon në fund të kampionatit. Tash për tash nuk mund të them se ku do të vazhdoj të luaj në sezoni e ardhshëm, pasi fokus i është në ndeshjet e mbeturat", ka thënë ai.

Feronikeli është në kërkim të daljes së Evropë nëpërmjet garës së Kupës, por edhe në kampionat me gjashtë pikët e marra nga dy ndeshjet është rikthyer seriozisht në garë për dy pozitat e para. Ardhja e Afrim Tovërlanit në krye të skuadrës nga Drenica e ka kthyer këtë klub në rrugën e duhur dhe kandidat për daljen në garat evropiane.

Drenica synon mbijetesën, jo finalen e Kupës

Pavarësisht se Drenica e ka edhe ndeshjen kthyese në kuadër të gjysmëfinales së Kupës, synim kryesor e ka mbijetesën dhe jo kualifikimin në finale të Kupës. "Në ndeshjen kthyese të Kupës kundër Prishtinës është e vështirë të arrihet përmbyssja, pasi rezultati i ndeshjes së parë është i lartë. Objekti i ynë mbetet që ta arrijmë mbijetesën", ka deklaruar Shillova

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Skuadra e Drenicës ka treguar formë të lartë në dy ndeshjet e fundit ku mori katër pikë ndaj skuadrave të forta siç janë Ballkani dhe Llapit. Madje në të dyja ndeshjet skuadra kuqezi luajti si mysafire dhe tash pret ndeshjet e radhës me qetësi më të madhe. Sulmuesi Alban Shillova, që

realizoi dy golat e fitores kundër Llapit, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se Drenica e ka synim që të vazhdojë me ndeshje të tillë në kampionat dhe ta arrijë mbijetesën. "Jemi të kënaqur se kemi arritur të marrim katër pikë në dy ndeshje, kurse synim e kemi të mbajmë këtë ritëm kundër rivalëve për mbijetesë. Atmosfera në klub është shumë e mirë dhe besoj se do ta arrijmë objektivin", ka thënë Shillova.



Ndryshe nga kampionati, Drenica në Kupë nuk është

treguar skuadër serioze përballë Prishtinës, ku pësoi humbje 3-0.

Edhe Shillova është i të njëjtët mendim me trajnerin Gani Sejdiu, i cili ditë më parë deklaroi se klubit kuqezi ka pak gjasa që të kualifikohet në finale. Ndesha kthyese e gjysmëfinales së Kupës zhvillohet nesër (e mëkurë). "Në ndeshjen kthyese të Kupës kundër Prishtinës është e vështirë të arrihet përmbyssja, pasi rezultati i ndeshjes së parë është i lartë. Objekti i ynë mbetet që ta arrijmë mbijetesën", ka deklaruar Shillova.

Sulmuesi i dëshmuar në futbollin e Kosovës është i huazuar në skuadrën e Drenicës, pikërisht nga Prishtina. Skuadra që drejtohet nga trajneri Gani Sejdiu aktualisht renditet në vendin e shtatë me 34 pikë të grumbulluara, kurse ndeshjen e radhës në kampionat e zhvillon kundër Flamurtarit në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj.

Behrami: Ende nuk kam mbaruar si futbollist

Genoa, 15 qershori - Mesfushori Valon Behrami ka thënë se është rikthyer në skuadrën e Genoas për të treguar se ende nuk ka mbaruar

ar si futbollist. 35-vjeçari në janar u largua nga Sioni dhe nënshkroi për klubin italian. "Kthimi te Genoa ishte një mundësi e madhe pas gjashtë

muajve të vështirë përmua. Mbi të gjitha, sinqerisht, doja të dëshmoja se nuk jam lojtar i mbaruar. Dua të më besojnë bashkëlojtarët dhe ta shfrytë-

zojnë përvojën time si një shkëmb për t'u mbajtur gjatë çasteve të vështira. Nuk flas vetëm përfushën, por edhe jashtë saj", ka thënë Behrami.



Marmarinos ligjëroi para trajnerëve të Kosovës

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Përgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, të dielën mbërëma ka ligjëruar para trajnerëve të Kosovës, me anë të platformave online. Tema e ligjërimit ka qenë sulmi tranzisional dhe sulmi i

hershëm. Ai ka ligjëruar përreth 50 minuta e në këtë ligjërim kanë marrë pjesë më shumë se 25 trajnerë vendorë të Kosovës. "Ligjërimi ka qenë shumë i mirëseardhur për trajnerët vendorë, të cilët kanë fituar përvojë nga përgjed-

hesi i Kosovës, i cili më herët kishte ligjëruar edhe para gjyqtarëve të Kosovës, përaportin gjyqtar-trajner. Për të gjithë trajnerët të cilët nuk kanë mundur të jenë pjesë e këtij ligjërimi, atyre do t'u dërgohet me e-mail/video e

ligjëratës nga Shoqata e Trajnerëve të Kosovës", thuhet në njoftimin e FBK-së. Marmarinos në shkurt është emëruar përgjedhës i Kosovës dhe në dy ndeshje ka dy fitore, kundër Islandës dhe Luksemburgut.



Sportistët elitarë dhe Shpresat Olimpike 2020 mbyllën me sukses trajnimet për shkathtësi mentale

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Rreth 40 sportistë elitarë dhe Shpresat Olimpike 2020 kanë mbyllur me sukses katër trajnimet e parapara të seminarit ndërkombëtar për shkathtësi mentale, i cili është organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Seminari është drejtuar nga trajnerët e organizatës australiane Optimization HUB: Graziella Thake, Elda Gjoka, Mel Roche dhe Paul Hutch. Programi i parë unik për avantazhin e sportistët, siguron shtyllën e katërt të performancës së sportistëve, që synojnë suksesin, konkretisht rrugën drejt medaljes së artë. "Trajnerët i kushtuan rëndësi të madhe edhe disiplinës mendore dhe faktit se si do të trajtosh fuqinë tënde mendore në mënyrë që të kesh ekuilibër jo vetëm në sport, por edhe në jetë. Pas katër javësh Optimization HUB do të bëjë një hartë të performancës së katër javëve të trajnimit. Sportistët përmes diskutimeve të ndryshme shprehën sfidat e tyre nëpër të cilat kanë kaluar gjatë muajve të pandemisë Covid-19", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Trajnimet e zhvilluara në dy grupe u mbajtën 'online' përmes platformës 'Zoom', derisa u monitoruan edhe nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani. Trajnimet i ndoqën sportistët elitarë si: Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Loriana Kuka, Akil Gjakova (xhudo), Egzon e Edon Shala (mundje), Albin Tahiri, Arbi Pupovci, Fiona Rrusta (skitari), Donjeta Sadiku (boks), Herolind Nishevci, Elhami Shabani, Fortesa Orana (karate), Musa Hajdari, ASTRIT Kryeziu, Vijona Kryeziu (atletikë), Dasar Xhambazi, Fjorda Shabani (not), Atdhe Luzhnica (shigjetari) dhe Drilon Ibrahim, Urata Rama (shenjëtar). Ndërsa te Shpresat Olimpike 2020 ishin: Laura Fazliu, Flaka Loxha, Fatjona Kasapi, Erza Muminoiq (xhudo), Albulena Gërvalla, Melos Gashi, Betim Maliqi (karate), Muhamet Rama, Alaudin Suma, Albina Deliu (atletikë), Arti Krasniqi, Eda Zeqiri (not), Patriot Behrami, Shpëtim Bajoku, Besart Pireva (boks), Edi Dvorani (shigjetari), Fatih Karabaxhaku (pingpong), Drin Kokaj (skitari), Don Berisha, Tringa Krasniqi (taekwondo).

Çdo 48 orë testime për Covid-19 në NBA

ORLANDO, 15 QERSHOR - Të gjitha skuadrat (22 të tillë) që do të grumbullohen në Orlando përtai vijuar kampionatin e NBA-së do të testohen çdo dy ditë. NBA-ja ka vendosur që çdo 48 orë, lojtarët, stafi dhe shoqëruarit të kryejnë testin anti-Covid 19. Testet do të nisin nga 23 qershori, kur do t'i nisin stërvitjet e para në grup. Ekipet

do të mbërrijnë në Orlando në datat 7-9 korrik dhe nga kjo datë do t'i nisin testet anti-Covid çdo dy ditë. Rinisja e kampionatit është planifikuar të ndodhë më 31 korrik në Orlando, ku 22 skuadrat do të luajnë fillimisht nga tetë ndeshje për ta kompletuar sezonin e rregullt. Më pas, 8 ekipet më të mira në seçilën



konferencë do ta vijojnë fazën "play-off"-it. NBA-ja parashikon të kryejë rreth 15 000 teste anti-Covid deri në fund të këtij sezoni.

Casillas tërhiqet nga kandidatura për kryetar të Federatës Spanjolle të Futbollit

Iker Casillas kishte njoftuar gjatë shkurtit se kishte vendosur të garojë për zgjedhjet e ardhshme për kryetar të Federatës Spanjolle të Futbollit. Katër muaj më vonë ai është tërhequr nga kjo garë. Ndërkohë, Luis Rubiales ka shprehur hapur qëllimet e tij për ta mbajtur pozitën e kryetarit të Federatës, të cilën e mori në maj të

2018-s. Casillas beson se progresi në lidhje me procesion elektoral, që tashmë ka filluar pre javës së kaluar, nuk ndihmon që procesi elektoral të jetë i drejtë dhe transparent siç mendon ai se dihet të jetë. Ai thotë se është i gatshëm t'i ndihmojë të gjitha nivelet e sportit dhe futbollit spanjoll për të bashkëpunuar në përmirësim.

SHKURT

Lazio ofron dy shqiptarë për Kumbullën

Marash Kumbulla është një nga emrat më të kërkuar këtë verë teksa Lazio nuk dëshiron ta lejojë largimin e tij nga Seria A. Mbrotësi shkodran ndiqet nga shumë klube të mëdha si Juventus, Interi, Napoli, Manchester Unitedi dhe Chelsea. Igl Tare e di vlerën e 20-vjeçarit dhe është i gatshëm për të marrë rreziqe për të pasi synon të ndërtojë një mbrojtje shumë të fortë për sezonin e ardhshëm. Tare është i gatshëm të bëjë një shkëmbim shqiptarësh pasi ka dy emra në listë për t'i ofruar në këmbim. I pari është mbrojtësi i krahut të majtë, Riza Durmishi, i kthyer nga huazimi te Nice, ndërsa i dyti është ylli i Kosovës, Valon Berisha, i cili në verë do të kthehet nga përvaja në Fortuna Dusseldorf.

PSG-ja konfirmon Tuchelin edhe për sezonin e ardhshëm

Trajneri Thomas Tuchel do të jetë në krye të skuadrës së Paris Saint Germainit edhe në sezonin tjetër. Lajmin e ka konfirmuar drejtori sportiv i PSG-së, Leonardo. "Tuchel ka më shumë se një vit në kontraten e tij dhe ai do të jetë në stol sezonin tjetër. Ai ka bërë mirë, rezultatet janë të mira. Rinovim? Ne duhet të mendojmë rreth tij", ka thënë Leonardo. Trajneri gjerman në të kaluarën e ka drejtuar edhe Borussia Dortmundin dhe Mainz 05.

Serena Williams mund të mos paraqitet në US Open

Pas Rafael Nadal, Nick Kyrgios e Novak Djokoviq, që janë shprehur të pasigurt për pjesëmarjen në US Open (nis më 31 gusht) edhe Serena Williams mund të mos marrë pjesë në grand slam-in amerikan. Idhulli amerikan i tenisit po mendon të mos luajë në turneun e shtëpisë për shkak të koronavirusit. Rregullat e rrepta të sigurisë që kanë vendosur organizatorët e turneut nju-jorkez mund ta shtyjnë "panterën e zezë" të marrë këtë vendim. Tenistët nuk pranojnë sidomos rregullin që duhet të kenë pranë vetëm një person të stafit me vete, çka do të thotë se Serena duhet të qëndrojë të paktën 20 ditë larg vajzës së saj (3 vjeç). "Mendoj se Serena dëshiron të luajë në US Open, por me këto rregulla nuk e di se si mund të luajë. Përveç stafit të saj, ajo mendon edhe për vajzën, pasi nuk mund të qëndrojë kaq gjatë larg saj. Gjithsesi, ditët në vijim do të marrim një vendim, duke parë se organizatorët e US Open nuk tërhiqen nga ideja e tyre", ka thënë Patrick Mouratoglou, trajneri i Serene Williamsit.

Modriq: Dua të pensionohem në Real

Mesfushori Luka Modriq është i bindur se edhe dy vjet mund të luajë në nivele të larta, kurse synim e ka pensionimin në skuadrën e Real Madridit. Mesfushori i Kroacisë iu bashkua Realit në vitin 2012 nga Tottenham Hotspur. "Jam i sigurt se mund të luaj në nivelin më të lartë edhe për dy vjet të tjera. Do të doja ta mbaroja karrierën në Real Madrid, por kjo varet edhe nga qëndrimi i klubit", ka thënë Modriq për "Gazzetta dello Sport". "Them se PSG-ja nuk do të luajë futboll deri në gusht. Po ashtu, është e lehtë të thuash Barcelona dhe Bayern München. Dhe mbi të gjitha, duhet pasur kujdes me Atletico Madridin dhe, natyrish, në mesin e favoritëve do të jetë edhe fituesi i duelit Manchester City - Real Madrid", ka deklaruar Modriq.

						Autor: GAZMEND MORINA	HUMBJA E AFTËSISË PËR TË LËVIZUR	SHKRIMTARE E JONA	GJYQTAR SPORTIV	FUSHA KU ZHVILLEHET NJË PËRLES- HJE (fig.)	DJALI KUN- DREJTI PRIN- DÉRVE TË VET (pashq.)	SHTET NË AZI (pashq.)	KONOPI	ZANORE	EPOKA ERE	PIANISTJA LULE	KËNGA E POPULLARI- ZUAR	
ISH-FUTBOLLISTI NË FOTO (BAYERN MUNICH)	SUPER MODELJA ANGLEZE CAMPBELL	VESHJE E TRASHË, E BËRË ME LESH DHIE SI NJË PELEIRINË (krah.)	OHajo, FLORIDA	BASHKËTING.	FEMRA LUFTETARE (mit. greke) ZHILLIM JONORMAL									ELIZA HOXHA SULMIMI				
SHTET NË AFRIKË							PEMË E VEN- DEVE TROPİ- KALE (shq.) ISMET MUNISHI								EVA PEPAJ PRINC ARAB (shq.)			
KOMPOZITORI DHOMI					ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH PAJISJE PËR ALARMMIM (sh.shq.)									MJET UDHËTIMI (shq.) PËRÇARJE				
DET I YNI					SHTET NË AFRIKË (pashq.) DEVE E VEN- DEVE TË AME- RIKËS (sh.shq.)									MUZIKANTI KRASNIQI (shq.) JETA E QETË DHE E LUMTUR		TINGULL QË FORMOHET NË MAJË TË GJUHËS (gram.)		
SMALTIM							JA (bised.) RENS ISTVUD			INDIAN DEFENCE REVIEË E KUDESSH- ME NE VEPRIME					U ARRATISA NGA BURGU POLITIKANI SHEHU			
NORA ISTREFI					BUJKU ARIAN MALIQI					SOLISTJA ... ZARI NJOLLOSJA					ORGANIZMI I NJERIUT (pashq.) SHFUQIZIM			
BASHKËTING.		BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.) SHKARKIMI NGA NJË POZITË					I DËRGUARI SPECIAL SULFUR, NATRIUM								ZANORE ROBERT RED- FORD			
RAFTI, DOLLAPI							DIKTATOR SOVJETIK (shq.) PRAROJ								RIFAT KUKAJ SKUADRA SPORTIVE			
BETIM			TONY ANDER- SON BËRTHAMOR			NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT ENVER PETROVCI					U THAVA BASHKËTING							
SUPER MODELJA HERZIGOVA					KA A DEM I PATREDHUR (shq.) LLOJ PAPA- GALLI						BURRË I MOS- HUAR RROGA VJET- ORE E PAPËS					SHKRONJA XVI LLOJ PIJE E NGROHTË ORIENTALE		
SHENJA QË PËRFACËSON NJË TINGULL MUZIKOR					FJALË POHUE- SE AKTORI HOL- LIVUDIAN PIT			FRYMA VEZAK, QË ËSHTË NË TRAJTË TË VEZËS					I FILLOVE ONTARIO LACROSSE ASOCIATION					
TOKË ME TË ARDHURA VJETOKE DERI NJËZET MIJË AKÇE NË VIT, QË U JEPEJ NE ZOTERIM FEUDALËVE SPAHINJ NË PERANDORINË OSMANE (shq.)	ZOG ME TRUP TË MADH E ME PENDË TË ZEZA TANTAL, FOS- FOR				NË DITËN E SOTME IPSVICH			LIGJ (vjet.) "TOP ALBANIA RADIO"						MINUS (Mat.) BUKURI, HIJESHI		BISHË MALI (pashq.)		
EMËR FEMRE MYS- LIMANE					BAKËRPUN- UESI ZANORE			QË KA TRUP TË SHËNDOSH, JETËDHËNËS BASHKËT.						MUZIKANTI ADRIAN RADIM		EDUARD ROSTON ZANORE		
LLOJ LOJE ME SHIGJETA TË VOGLA					MUNGESË E SHTYPJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE						ZEZAKU, I ZIU							

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i "Apollonia" Sh.p.k. fabrikë për prodhimin e bllokave nga argjila, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 07.07.2020, në ora 12,00 në hapësirat e Fabrikës "APOLLONIA" Obiliq, Komuna e Obiliqit, do të organizohet debat publik nga operatori i "Apollonia" Sh.p.k. fabrikë për prodhimin e bllokave nga argjila, në Lazarevë, Komuna e Obiliqit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Apollonia" Sh.p.k Llazarevë, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e argjilës në Llazarevë komuna e Obiliqit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2020 në ora 10:00 në objektet e Fabrikës "Apollonia" sh.p.k. në Llazarevë, zona industriale, Obiliq do të organizohet debat publik nga kompania "Apollonia" Sh.p.k Llazarevë, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e argjilës në Llazarevë komuna e Obiliqit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ramë Bllaca" – Bllacë
Komuna: Suharekë
Data: 15.06.2020
Emri i kontratës: Blerja e pajisjeve teknologjike
Numri i kontratës: ESIP/SDG/053-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor pëta përkrahur Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Shkollën "Ramë Bllaca" në Bllacë – Suharekë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
- Laptop – 4 copë
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e sukseshtme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit.
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mireseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësisht teknik në adresën e Shfmu "Ramë Bllaca" në Bllacë – Suharekë, më së largu deri më 23.06.2020
4. Specifikimi i hollësisht teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitur në kuadër të një dokumenti të quajtur "Ftesë për ofertë-Mallra", do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruanjë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Shkelzen Zekoli
Telefoni: 044/823-348
E-maili: shkelzenzekoli@hotmail.com



Lumé's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumé's Details

@lumesdetails

Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

C.nr.335/2011

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVE, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Nazmi Neziri dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, rr. "Lidhja e Pejës" pnr., kundër të paditurit Baki Sabit Paqarada nga Podujeva, rr. "Kongresi i Manastirit" pnr., tani me adresë të panjohur jashtë shtetit diku në Gjermani, baza e kontestit për Rimburësim dëmi në vlerë prej 15.454.00 Euro, jashtë seance me datë 08.06.2020, mori këtë :

A K T V E N D I M

Tohet paditësi Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, rr. "Lidhja e Pejës" pnr., që në padinë, kundër të paditurit Baki Sabit Paqarada nga Podujeva, rr. "Kongresi i Manastirit" pnr., tani me adresë të panjohur jashtë shtetit diku në Gjermani, të bëjë rregullimin dhe precizimin e padisë dhe kërkesëpëdisë për sa i përk provave materiale dhe atë: të paraqesë të përkthyerë në Gjuhën Angleze Aktvendimin mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe Shpalljen C.nr.335/2011 të dt.05.03.2020 të dyja në kopje.

Padinë e përmirësuar-provat e kërkua e shëtë i detyruar t'a paraqes kësaj gjykate në afat prej 3 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimi.

Nëse padia nuk kthehet në afatin e caktuar në këtë gjykate, do të konsiderohet se padia është tërhequr, ndërsa po që se kthehet e pa përmirësuar e njëjtë do t'ë hedhet.

A r s y e t i m

Paditësi Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, rr. "Lidhja e Pejës" pnr., ka paraqitë me datë 11.10.2011, pranë Gjykatës padi kundër të paditurit Baki Sabit Paqarada nga Podujeva, rr. "Kongresi i Manastirit" pnr., tani me adresë të panjohur jashtë shtetit diku në Gjermani.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë së paditësit gjeti se Padia e Paditësit duhet të plotësohet me përbajtjen e padisë-provat materiale Aktvendimin mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe Shpalljen C.nr.335/2011 të dt.05.03.2020 në gjuhën angleze.

Andaj Gjykata duke marrë parasysh se padia nuk i përbush konditati e parapara në dispozitën e nenit 99.2 dhe 99.3 të LPK-së, ka vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në bazë të nenit 102 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË

C.nr.335/2011 datë 08.06.2020

Këshilla Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë.



C.nr. 335/2011

BASIC COURT OF PRISHTINA (PRISHTINË) – BRANCH IN PODUJEVA (PODUJEVË), General Department-Civil Division, as civil court of first instance, with judge Nazmi Neziri and the minute keeper Afërdita Ejupi, deciding in the juridical-civil case of the claimant Kosova Insurance Bureau (KIB) from Prishtina, "Lidhja e Pejës" str. nn, now in unknown residence address abroad, somewhere in Germany, the respondent Baki Sabit Paqarada from Podujeva, "Kongresi i Manastirit" str. nn, now in unknown residence address abroad, somewhere in Germany, the contest base: Damage Reimbursement in the amount of 15,454.00 Euro, out of the proceeding on date 08.06.2020 issued the following:

I N J U C T I O N

Invited Kosova Insurance Bureau (KIB) from Prishtina, "Lidhja e Pejës" str. nn, in the claim against the respondent Baki Sabit Paqarada from Podujeva, "Kongresi i Manastirit" str. nn, now in unknown residence address abroad, somewhere in Germany, to regulate and precise the claim and appeal request regarding the material evidences as follows: to submit translated in English language the Injunction on assigning the temporary representative and Annunciation C. nr. 335/2011 of date 05.03.2020 both in two copies.

Obligated to submit to this court the improved claim-requested evidences within the term of 3 days from the delivery date of this Injunction.

In case the claim is not returned within the foreseen term in this court, shall be considered that the claim is withdrawn, and in case it is returned not improved the same will be rejected.

R e a s o n i n g

Kosova Insurance Bureau (KIB) from Prishtina, "Lidhja e Pejës" str. nn, on date 11.10.2011 has submitted claim to the Court against the respondent Baki Sabit Paqarada from Podujeva, "Kongresi i Manastirit" str. nn, now in unknown residence address abroad, somewhere in Germany.

The court after the review of the claim of the claimant found out that the Claim of the Claimant shall be supplemented with the content of the claim-material evidences Injunction on assigning the temporary representative and Annunciation C. nr. 335/2011 of date 05.03.2020 in English Language.

Therefore, the court considering that the claim does not fulfil the conditions set forth in the disposition of art. 99.2 and 99.3 of LCK, decided as in the dispositive of the present Injunction, pursuant to art. 102 of LCP.

BASIC COURT OF PRISHTINA (PRISHTINË) – BRANCH IN PODUJEVA (PODUJEVË),

C.nr.335/2011 date: 08.06.2020

Legal Remedy: Against the present injunction is not allowed appeal.

Judge:

Nazmi Neziri
/Signature/
/Official Stamp of the Court/

Prishtina, on June 12th, 2020

I attest by my signature below that I have translated the document from Albanian to English accurately to the best of my professional ability.

DENIDA BERISHA
JUDICIAL TRANSLATOR
Agjensi për përkthime "Alfa Com" - Rr. Fazli Graçevci 7, Prishtinë, Email: ag.alfa.com@gmail.com;
Phone: +383 (0) 44 584 305; +383 (0) 44 971 325



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY -SUHAREKË

Kryetari i Komunës 01-nr.465-22/219

Dt. 04.06.2020 - Suharekë

Ne bazë të nenit 4, nenit 10 te Ligjt për Shpronësimin e pronës së palujtshme Nr.03-L-139 dt. 26 mars 2009 te Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjt mbi shpronësimin e pronës së palujtshme nr.03/L-205 dt. 10 dhjetor 2010, nenit 44 te Ligjt për Procedurën e përgjithshme Administrative 0/L-031, pas shqyrtimit te komenteve dhe deklaratave te palëve, brenda afatit ligjor, si dhe duke u bazuar në Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim te palujtshmerisë për ndërtimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në ZK. Reqan, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë :

V E N D I M P R E L I M I N A R

(Për ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar)

I.MIRATOHET kërkesa e subjektit kërkues, K.R.U "Hidroregjioni Jugor" njësia punuese në Suharekë, për shpronësimin e pjesës së palujtshmerisë për interes publik dhe për ndërtimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në fashtin Bukosh e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116036-01164-0, në sip. prej: **6000 m²** (nga sip. e përgjithshme në sip. prej: 9961 m²) ZK. Reqan, pronë private e evidentuar në emër të Fatmir (Hysen) Baraliu nga fshati Bukosh.

II. Vërtetohet se ndërtimi i impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë si ne pikën 1. te këtij vendimi është qëllimi i ligjishem dhe në sherbim te arritet se këtij qëllimi.

III. Zotuesi i interesit të pronës së shpronësuar, do të kompenzohet konform dispozitave të Ligjt për Shpronësimin e pronës së palujtshme.

IV. Vendimi Preliminari, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit te tij, Organi shpronësues do të ia dergon, zotëruesve te interesit te pronës dhe personave te tjerë te cilët pretendojnë se u takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar, bazuar ne nenin 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

V. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës, pas miratimit të Vendimit Preliminari, Organi shpronësues e shpall Vendimin ne një gazetë zyrtare me tirazh me te madhë në Kosovë, ndërsa ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në këtë Gazetë

A r s y e t i m

Subjekti kërkues, K.R.U "Hidroregjioni Jugor-njësia punuese në Suharekë, sipas kërkësës nr.104-65973 te datës 18.09.2019, ka kerkuar iniciimin e procedurës për shpronësimin e një pjese të pronës private për ndërtimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në zk. Reqan.

Subjekti kërkues, kerkesës ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshem i cili parashifet me dispozitën e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjt për shpronësimin e pronës së palujtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit te kërkësës konklidon se shpronësimi i palujtshmerisë te evidentuar ne dispozitiv te ketij Vendimi Preliminari është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtë qellim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qellimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë çështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkësës për shpronësim të palujtshmerisë Nr. 01 nr.465-4046/20, dt. 13.01.2020 ka miratuar kërkësën e subjektit kërkues- K.R.U "Hidroregjioni Jugor" – njësia punuese në Suharekë për shpronësimin e pronës së palujtëshme për interes publik dhe për ndërtimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundershtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtij Vendimi Preliminari. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjt për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkues :

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës

Bali Muhamremaj



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbraja Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

P R I S H T I N Ë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë

CV

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpjete

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- Sinan Ramadani shpall të pavlefshme licencën e infermierisë së përgjithshme Nr. KO-0843-05-20 Prishtinë.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m², e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet përfiqt familjar. Tel: 044-171-328.
- Jap banesë me qira afër 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj tu jap banesën me qira përfiqt ose përfiqt. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet përfiqt ose përfiqt. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përfiqt. Banesa është 60 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Përfiqt mund të na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshoj banesë me qira përfiqt apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër detyrë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër detyrë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian katër i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet përfiqt studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përfiqt, preferohet përfiqt apo tre studentë, mund të merret përfiqt kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 €uro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188.
- Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Përfiqt mund të na kontaktoni në numrin e telefonit: 049-392-275.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër i tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi 2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfiqt info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi 2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfiqt info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Përfiqt mund të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit te bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, përfiqt info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Përfiqt informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Përfiqt informata në tel: 044/171-328.
- Lëshoj banesë e re me qera në qendër të prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet përfiqt afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 044/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Përfiqt mund të na kontaktoni në numrin e telefonit: 049-440-466.
- Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Përfiqt informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme përfiqt. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Përfiqt mund të na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numri të viberit.
- Kërkojmë 4 bashkëbanues, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, katër i l-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi përfiqt person është 50 euro plus shpenzimet. Përfiqt info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afér AAK-së. Përfiqt informata lajmërohuni në tel: 044/162-783.
- Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, katër -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes është 044-132-368.
- Kërkojmë dy bashkëbanues, mundësishët të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përboll Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afér shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesa mund të shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a blue box lists "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order. To the right, there are images of a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola on a wooden surface.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



The advertisement features a circular tin of Meka Pashtetë Pule (liver pâté) against an orange background. The tin is labeled "MEKA HALAL FOOD" and "PASHTETË PULE". It includes a "gluten free" badge, a "no no mish pul" badge with a chicken icon, and a gold ribbon banner at the bottom that reads "ciliësi e garantuar". A small "pa konservues" label is at the bottom. The tin shows a slice of the pâté with herbs and red pepper.